



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 3/2024 regjistër (JR)
Datë 18.01.2024

Nr. 71 i vendimit
Datë 13.10.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 13.10.2025, ditën e hënë, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, znj. Blerina Muço, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 711, datë 01.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi, e më pas në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, dëgjoi në seancë publike subjektin e rivlerësimit, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 711, datë 01.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Blerina Muço (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1 ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2 DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës² për subjektin e rivlerësimit, ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Blerina Muço.

2.3 KLGj-ja, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit³, znj. Blerina Muço.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, pasi kreu një hetim administrativ të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit, arriti në konkluzionet si vijojnë:

¹ Raporti i ILDKPKI-së, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2018.

² Raporti mbi kontrollin e figurës, me nr. prot., {***}, datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 12.07.2022, të KDZH-së.

³ Raporti për analizimin e aftësive profesionale, me nr. {***} prot., datë 13.10.2021.

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë, duke mos u gjendur në kushtet e përcaktuara nga shkronja “a” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve ndër vite, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme dhe gjendur në kushtet e parashikimit të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] subjekti i rivlerësimit, znj. Blerina Muço, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...] subjekti i rivlerësimit: - ka shfaqur mangësi të theksuara në mënyrë të përsëritur, në lidhje me afatet e gjykimit të çështjeve; - nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për të shmangur gjykimet e saj në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, të cilat, në dukje, kanë cenuar paanshmërinë e magjistratit; - ka përdorur mbiemra të ndryshëm nga mbiemri zyrtar në praktika, akte të ndryshme dhe në të gjitha çështjet e gjykuara në gjykatë; - ka kryer veprime duke shtrembëruar faktet dhe provat shkresore, si dhe veprimet e saj kanë pasur si qëllim shfaqjen e një situatë tjetër, joreale (lidhur me deklaratat periodike të bashkëshortit), fakte këto që cenojnë figurën e saj si magjistrate. Në këtë aspekt, Komisioni e vlerësoi kriterin profesional duke analizuar të gjitha gjetjet e konstatuara për subjektin e rivlerësimit.

Gjithashtu, nga vlerësimi tërësor i çështjes, Komisioni konkludoi se, në procesin e rivlerësimit të këtij subjekti, evidentohen problematika të tilla, që mund të cenojnë kriteret e rivlerësimit, pasi u evidentuan elemente të arsyeshme, të konsiderueshme apo të perceptueshme, që cenojnë besimin e publikut, sipas pikës 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

4. Komisioni, në përfundim, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “c”, dhe nenit 61, pikave 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 711, datë 01.11.2023, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Blerina Muço, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 711, datë 01.11.2023, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë, mbi bazën e parashtrimeve në këtë ankim dhe argumenteve që do të paraqiten në seancë gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shkaqe ankimore të aspektit material, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale.

6. Shkaqet e ankimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim:

6.1. Lidhur me pasurinë “apartament banimi, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe 138 m², ndodhur në ‘{***}’, Tiranë”, të blerë në vitin 2000, subjekti i rivlerësimit pretendon se, gjatë hetimit administrativ, ndryshe nga sa konkludon Komisioni, ka provuar se procedura e blerjes së apartamentit është plotësisht ligjore, çmimi është real dhe nuk ekziston asnjë konflikt interesi në gjykimin e çështjeve nga subjekti, me palë shitësin e kësaj pasurie, shoqërinë “{***}” ShPK.

6.2. *Lidhur me gjendjen cash, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën e pasurisë vetting*, subjekti i rivlerësimit pretendon se pavarësisht se Komisioni ka evidentuar në disa vite problematika në deklarimin e gjendjes *cash*, kjo nuk përllig konkluzionin se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me gjendjen *cash* në shtëpi në deklaratat periodike vjetore, në raport edhe me gjendjen *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti nuk ngre pretendime sa i përket analizës financiare për këto vite, por kërkon nga Kolegji të konsiderohet si i pabazë vlerësimi i Komisionit se: “[...] pretendimet e subjektit janë kryer në kundërshtim me ligjin, duke shtrembëruar faktet dhe provat shkresore, si dhe veprimet saj për të shfaqur një situatë tjetër joreale, cenojnë figurën si magjistrate. Ky vlerësim i Komisionit do të merret në konsideratë në qëndrimin përfundimtar, bazuar edhe në çështjet e tjera të evidentuara për subjektin e rivlerësimit”.

6.3. *Lidhur me të ardhurat e siguruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nga shërbimet e konsulencës me shoqërinë “{***}” ShPK / “{***}” ShPK,*⁴ subjekti i rivlerësimit kërkon që Kolegji, në koherencë dhe me praktikën e tij, të njohë si të ligjshme të ardhurat e bashkëshortit nga shërbimet e konsulencës me këtë shoqëri, të cilat do të ndryshonin tërësisht rezultatet e analizës financiare. Arsyetimin mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, Komisioni e ngre mbi fajësinë e prezumuar të bashkëshortit, me pretendimin se ky i fundit nuk ka treguar kujdesin, vigjilencën, ndershmërinë e duhur për të kontrolluar përmbushjen e detyrimeve nga një shoqëri, në të cilën ai nuk ka asnjë lloj funksioni. Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji rivlerësimin e të ardhurave nga shërbimet e konsulencës me shoqërinë “{***}” s. r. l., si dhe nga pagat e bashkëshortit si punëmarrës pranë shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK, “{***}” ShPK” dhe “{***}” ShPK, për të cilat kërkon njohjen si të ligjshme, jo vetëm të pjesës së tatueshme të tyre, por dhe të pjesës tjetër, e cila është kaluar rregullisht në bankë.

6.4. *Lidhur me shpenzimet për shkollimin e djalit në Kanada*, pavarësisht se Komisioni ka përdorur një standard jo të drejtë në përlllogaritjen e tyre, subjekti pretendon se ato janë deklaruar rregullisht dhe mbulohen nga të ardhurat vjetore. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, pretendon se Komisioni ka synuar nëpërmjet aludimeve të krijojë situata të paqena, të cilat kanë rënduar pozitën e subjektit, nisur vetëm nga fakti që, nga ana e saj, nuk është mundur të sigurohet informacion i plotë mbi llogarinë bankare të djalit në Kanada, më i hershëm se shtatë vite nga momenti kur është kërkuar nga Komisioni.

6.5. *Lidhur me rezultatet e analizës financiare për periudhën e rivlerësimit*, subjekti pretendon se rezultatet negative të analizës financiare të Komisionit vijnë si rezultat: (i) i mospërshirjes dhe përjashtimit të të ardhurave të bashkëshortit nga shërbimet e konsulencës ligjore, si dhe (ii) i mënyrës së llogaritjes së shpenzimeve të jetesës së djalit të Kanada. Sipas subjektit, rivlerësimi i analizës financiare nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve të ankimit, do të ndryshonte situatën financiare, e cila do të rezultonte me balancë pozitive.

7. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim:

7.1. *Lidhur me tejkalimin e afateve të gjykimit*, konstatuar në analizë të dhënave të raportit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe në disa nga denoncimet e publikut, subjekti pretendon se, në pamje të parë, është e drejtë, por, sikurse ka parashtruar gjatë hetimit administrativ në Komision, kjo problematikë është krijuar si pasojë e zhvillimit të seancave gjyqësore, për shkak të marrjes së

⁴ Në vijim “{***}” ShPK, ndryshuar emri nga “{***}” ShPK.

provave të reja, qëndrimin dhe kërkesave të palëve, ngarkesës në punë, apo situatave të tjera procedurale, të pavarura nga subjekti, të cilat kanë pamundësuar përfundimin e gjykimit brenda afatit ligjor. Po ashtu, subjekti parashtron përpara Kolegjit për rivlerësim edhe konkluzionet e Komisionit sa i përket konstatimeve *lidhur me mosrespektimin e vendimit unifikuës të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 3, datë 06.12.2013.*

7.2. Lidhur me përdorimin e mbiemrave të ndryshëm nga mbiemri i regjistruar në gjendjen civile. Subjekti i rivlerësimit nuk dakordësohet me qëndrimin e Komisionit, se *kjo sjellje e subjektit cenon etikën, rolin dhe figurën e një magjistrati*, si dhe kërkon nga Kolegji që të rishikojë konkluzionin e Komisionit, mbi bazën e argumenteve që ka parashtruar në prapësimet e rezultateve të hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore.

7.3. Lidhur me konstatimin e Komisionit mbi konfliktin e interesit, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) konkluzioni i Komisionit, sa i përket çështjeve të rezultuara me shoqërinë “{***}” ShPK, përveç se i paqartë, ngrihet mbi premisën se: “[...] Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti i subjektit ka pasur marrëdhënie favorizuese me këtë shoqëri, duke konkluduar të dyja palët në shmangie dhe përfitime financiare për mospagim detyrimesh tatimore [...]”, premisë e cila, sipas subjektit, është thjesht absurde, në kuptimin logjik, dhe absolutisht e pabazë, në kuptimin juridik; (ii) sikurse sqaruar në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim procedural në dy çështjet e shortuara elektronikisht me shoqërinë “{***}” ShPK. Në këto kushte, konkluzioni i Komisionit për konflikt interesi, pavarësisht kërkesës për heqje dorë nga gjykimi, nuk qëndron.

8. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këto akte shkresore: (i) Kërkesë nr. {***} prot., datë 10.01.2024, drejtuar kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me ngarkesën e saj si gjyqtare gjatë viteve 2013 – 2022; numrin e vendimeve të lëna në fuqi nga Gjykata e Apelit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës; (ii) Kërkesë datë 08.07.2021, drejtuar kryetarit të kësaj gjykate, për justifikim mosparaqitjeje në punë, në datat 02.08.2021 dhe 19.08.2021, si rezultat i kryerjes së lejes vjetore; (iii) 2 (dy) kërkesa “Për heqje dorë nga gjykimi”, datë 29.06.2023, dhe vendimet e zëvendëskryetarit të gjykatës për pranimin e kërkesës për heqje dorë, si dhe (iv) Lista e shortit të datës 26.05.2023.

9. Subjekti i rivlerësimit, më datë 09.09.2025, paraqiti në Kolegji parashtrime me shkrim mbi shkaqet e ngritura në ankim, sikurse parashikon neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), duke kërkuar shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, administrimin e provave të reja bashkëlidhur parashtrimeve, si dhe ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur këto akte shkresore:

(i) Vendim nr. {***}, datë 01.03.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt: detyrimin e palës së paditur, shoqëria “{***}” ShPK, të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale, detyrim i cili rrjedh nga “Marrëveshja e bashkëpunimit”, datë 15.08.2005, lidhur mes palëve. Ky vendim mban shënimin se “ka marrë formë të prerë dhe është lënë në fuqi, me vendimin nr. {***}, datë 11.12.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”.

(ii) Shkresë nr. {***} prot., datë 19.03.2025, “Kthim përgjigje”, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, drejtuar Zyrës së Përmbarrimit Privat “{***}” ShPK, përmes së cilës, informon se është bërë zbatimi i vendimit nr. {***}, datë 11.12.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe, nga shoqëria “{***}” ShPK, nuk ka detyrime të papaguara për tatimin e mbajtur në burim, që ka rezultuar nga zbatimi i vendimit të mësipërm.

(iii) Shkresë nr. {***} prot., datë 04.09.2025, “Kthim përgjigje”, e Drejtorisë së Përgjithshme të

Tatimeve, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe, për dijëni, Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përmes së cilës, informon mbi zbatimin e vendimit nr. {***}, datë 11.12.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

(iv) Vërtetim nr. {***} prot., datë 18.07.2025, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me raportet për paaftësi për punë që subjekti i rivlerësimit ka marrë për periudhën nga nëntori 2022 deri në qershor 2023.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

(a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Blerina Muço, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

(b) Legjitimimi i ankuesit

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet (*ratione personae*) në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

(c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

12. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 711, datë 01.11.2023, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Blerina Muço, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, më datë 17.09.2025, mbi bazë aktesh.

12.1. Në kushtet kur, qëndrimi i Komisionit mbi ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga shërbimet e konsulencës me shoqërinë “{***}” ShPK, ka zënë një peshë të konsiderueshme në marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, gjatë kësaj seance në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 49/2012, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, me qëllim konstatimin e saktë dhe të plotë të situatës faktike, që lidhet me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

12.2. Në seancën gjyqësore publike të datës 07.10.2025, subjekti i rivlerësimit u dëgjua nga trupi gjykues, teksa paraqiti sqarimet e saj lidhur me situatën faktike rreth pagimit të detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur, bashkëshorti i saj, nga shërbimet e konsulencës, iu

përgjigj pyetjeve së gjyqtares relatores të çështjes dhe të trupit gjykues, si dhe specifikoi aktet për të cilat kërkoi të merren nga Kolegji në cilësinë e provës.

12.3. Pasi u konsultua, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të marrë në cilësinë e provave të reja, aktet si më poshtë: (1) Vendimin nr. {***}, të datës 01.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (2) Shkresën nr. {***} prot., të datës 19.03.2025, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që është një komunikim “kthim përgjigje” Zyrës së Përmbartimit “{***}” ShPK, si dhe (3) aktin tjetër, po të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nr. {***}, i datës 04.09.2025, me lëndë “Kthim përgjigje”, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe, për dijeni, Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

12.4. Trupi gjykues, pasi subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte kërkesa të tjera procedurale, vendosi mbylljen e hetimit gjyqësor të çështjes. Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit Blerina Muço, i kërkoi Kolegjit ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 711, datë 01.11.2023, dhe konfirmimin e saj në detyrë.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

*B/1 Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga shërbimet e konsulencës me shoqërinë “{***}” ShPK ose “{***}” ShPK (në vijim “{***}” ShPK)*

13. Komisioni ka vlerësuar se të ardhurat e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, me burim marrëveshjen e bashkëpunimit të bashkëshortit të subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK, për të cilat nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore, nuk do të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, të cilat plotësojnë kriteret e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, nuk janë përfshirë në analizën financiare.
14. Subjekti i rivlerësimit, në ankim pretendon se, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar e provuar se bashkëshorti i saj ka lidhur një Marrëveshje Bashkëpunimi (*Kontratë Shërbimi*), më datë 15.08.2005, me shoqërinë “{***}” ShPK, së cilës ai i ka ofruar shërbime konsulence ligjore dhe, nga kjo e fundit, i janë paguar tarifatat përkatëse, të cilat arrijnë vlerën prej 73.000 eurosh. Referuar pikës 7 të kësaj marrëveshjeje, shoqëria ka marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit, që rrjedhin nga kjo pagesë, që do të thotë pagimin e tatimit në burim, si i vetmi detyrim ligjor i aplikueshëm në këtë rast. Pagesat janë bërë të gjitha në rrugë bankare dhe vërtetohen plotësisht me dokumentacionin që subjekti ka depozituar gjatë hetimit administrativ në Komision. Kjo marrëveshje, sipas subjektit, nuk disponohet nga ILDKPKI-ja, pasi formularët e deklarimit në këtë periudhë, nuk shoqëroheshin me dokumentacion provues. Komisioni ka arritur në përfundime që, sipas subjektit, injorojnë bazën ligjore të marrëveshjes, përgjegjësitë e palëve në të, si dhe situatën faktike. Sa i takon diferencës midis kohës së vlefshmërisë së kontratës (afatit të marrëveshjes), dhe kohës së kryerjes së pagesave, subjekti i rivlerësimit pretendon se, sikurse provohet me “Marrëveshjen për shlyerje detyrimesh në të holla”, të datës 14.05.2009, lidhur mes bashkëshortit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, kjo e fundit e ka njohur detyrimin e papaguar në vlerën prej 19.000 eurosh, detyrim i cili është shlyer i ndarë në dy pjesë, 12.000 euro në vitin 2009 dhe 7.000 euro në vitin 2010, të deklaruar në mënyrë korrekte, si detyrime të prapambetura në deklaratat periodike respektive. Duke i qëndruar prapësimeve të paraqitura në Komision, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, kërkon një vlerësim të ri objektiv të këtyre të ardhurave, si dhe përfshirjen e tyre në analizë financiare, si të ardhura të ligjshme.

15. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të administruara në fashikuj, i pretendimeve të subjektit në ankim, në parashtrime, si dhe në seancën gjyqësore publike, konstaton dhe vlerëson si vijon:

15.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga shërbime konsulence të bashkëshortit nga shoqëria tregtare “{***}”/ “{***}” ShPK, Tiranë, si konsulent juridik, për vitet 2005 – 2010, në shumën 73.000 euro. Në funksion të deklarimeve, subjekti ka paraqitur Deklaratën nr. {***} prot., të datës 07.01.2017, të administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, në të cilën deklaroi se z. M. M., me profesion jurist, ka pasur marrëdhënie bashkëpunimi me këtë shoqëri, në bazë të së cilës, ai ka ofruar shërbime konsulence ligjore dhe i janë paguar tarifatat përkatëse, në një vlerë totale prej 73.000, pa përcaktuar njësinë monetare të monedhës.

15.2. Në deklaratat e interesave periodikë vjetorë (në vijim “DIPV”) të viteve 2005 – 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon:

15.2.1. Në DIPV-në e vitit 2005: *Shpërblime të bashkëshortit për konsulencë juridike, “{***}” ShPK, deri në dhjetor 2005, në llogarinë {***}. Vlera: 10.000 euro dhe 250.000 lekë*”.

15.2.2. Në DIPV-në e vitit 2006: *“Të ardhurat e bashkëshortit për shërbime konsulence ndaj shoqërisë “{***}” ShPK. Vlera: 24.000 euro*”.

15.2.3. Në DIPV-në e vitit 2007: *Shpërblime konsulence të bashkëshortit nga shoqëria “{***}” ShPK (“{***}”) dhe shoqëria “{***}”. Vlera: 27.000 euro.*

15.2.4. Në DIPV-në e vitit 2008, nuk ka deklaruar të ardhura nga shërbimet e konsulencës me këtë shoqëri.

15.2.5. Në DIPV-në e vitit 2009 dhe DIPV-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit, të prapambetura nga kontrata e shërbimit me shoqërinë “{***}” (ish-“{***}”), përkatësisht në vlerat 12.000 euro dhe 7.000 euro.

15.3. Në pyetësorin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektin të vërtetojë me dokumentacion, që për këto ardhura, të jenë paguar detyrimet tatimore (kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimi në burim në rast kontrate shërbimi, etj.). Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të këtij pyetësi, ka deklaruar se: *“[...], shoqëria “{***}” ShPK dhe “{***}” janë i njëjti subjekt tregtar, me të cilin bashkëshorti ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi (kontratë shërbimi), datë 15.08.2005. Referuar pikës 7 të marrëveshjes, shoqëria ka marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit, që rrjedhin nga kjo pagesë, që do të thotë pagimin e tatimit në burim, si i vetmi detyrim ligjor i aplikueshëm në këtë rast. Pas kërkesave tona drejtuar organeve kompetente, nuk na është vënë në dispozicion asnjë informacion në lidhje me përmbushjen apo jo të këtij detyrimi nga shoqëria në fjalë. Bashkëlidhur gjeni një kopje të marrëveshjes. Pagesat janë bërë të gjitha në rrugë bankare dhe vërtetohen plotësisht me dokumentacionin që kemi depozituar, vërtetim nga “{***}” ShPK dhe statement-e bankare*”.

15.4. Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti ka paraqitur një marrëveshje bashkëpunimi të thjeshtë, jonoteriale, datë 15.08.2005, e cila nuk disponohet në dosjen e ILDKPKI-së. Në pikën 6 të saj parashikohet se shoqëria “{***}” do të shpërblejë z. M. M. për angazhimin e tij në favor të shoqërisë, mbi bazën e kushteve të kësaj marrëveshje, në një shumë prej jo më pak se 24.000 euro në vit. Shpërblimi vjetor do të përfshijë edhe shtesa rast pas rasti, parashikim ky, që nuk përkon me vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore, të përfituara ndër vite nga kjo shoqëri. Në pikën 7 parashikohet se “{***}” ShPK, merr përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit shqiptar, që rrjedhin nga pagimi i këtij shpërblimi, konform

legjislacionit në fuqi, ndërsa në pikën 8 parashikohet se *kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3-vjeçare nga data e nënshkrimit të saj*, parashikim ky, që, gjithashtu, nuk përkon me deklaratimet e subjektit, lidhur me vitet që ka përfituar të ardhura nga kjo shoqëri.

15.5. Sa më sipër, në kushtet kur për këto të ardhura nuk u provua pagesa e detyrimeve tatimore në burim nga organet tatimore⁵, si dhe shoqëria “{***}” ShPK nuk iu përgjigj kërkesave të Komisionit⁶ në drejtim të konfirmimit të marrëdhënies së konsulencës dhe shlyerjes së detyrimeve tatimore, Komisioni nuk i ka përfshirë ato si të ardhura të ligjshme në analizë financiare, duke i kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën sa i përket burimit të ligjshëm të tyre, pagimit të detyrimeve tatimore, si dhe mungesës së provueshmërisë së marrëveshjes.

15.6. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e rezultateve të hetimit, ka dhënë shpjegime lidhur me konstatimet e Komisionit mbi: (i) mospërputhjet në deklarinimin e këtyre të ardhurave, (ii) vlefshmërinë e marrëveshjes së vitit 2005, duke referuar nenin 913 e vijues të Kodit Civil, pasi kontrata e porosisë nuk bën pjesë në veprimet juridike formale, të cilat kërkojnë detyrimisht formën noteriale për vlefshmërinë e tyre, si dhe (iii) diferencën midis kohës së vlefshmërisë së kontratës (2005 – 2008) dhe kohës së shlyerjes së pagesave deri në vitin 2010.

15.7. Subjekti ka shpjeguar se pagesat që rezultojnë për vitet 2009 dhe 2010 janë rezultat i përmbushjes së detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e datës 15.08.2005, por që nuk është paguar në kohën e duhur nga shoqëria. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur “*Marrëveshje për shlyerje detyrimesh në të holla*”, datë 14.05.2009, lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, sipas së cilës, shoqëria njih detyrimin e papaguar në vlerën prej 19.000 eurosh, detyrim i cili është shlyer i ndarë në dy pjesë: 12.000 euro në vitin 2009 dhe 7.000 euro në vitin 2010.

15.8. Subjekti i rivlerësimit, në kushtet e mungesës së informacionit nga shoqëria “{***}” ShPK dhe, në kushtet e pamundësisë së organeve tatimore për të ofruar të dhëna mbi pagesën e detyrimit tatimor, shpjegon se bashkëshorti, më datë 06.10.2023, ka depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kërkesëpadinë me objekt: *Detyrimin e palës së paditur, shoqëria*

⁵ (1) Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, me shkresën nr. {***}, datë 23.6.2023, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të dërguar të dhëna dhe dokumentacion për pagesën e tatimit në burim për z. M. M. nga shoqëria “{***}” ShPK, ka informuar se: [...] nga verifikimi në sistemin tatimor c@ts, subjekti rezultoi të jetë i regjistruar me përgjegjësi tatimore “Tatim mbi vlerën e shtuar” dhe “Tatim mbi fitimin”, dhe ka deklaruar në DRT Elbasan deri në periudhën Mars 2001 dhe, mbas kësaj periudhe, pranë DRT-së Elbasan, nga ana e subjektit, nuk ka deklarime dhe pagesa, si dhe, konkretisht, pagesa për “Tatimin e mbajtur në burim”. (2) Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me shkresën nr. {***}, datë 21.06.2023, ka informuar se: [...] për periudhën të cilës i referoheni, përkatësisht vitet 2005 – 2010, detyrimi për përgjegjësinë tatimore “Tatim në burim” paguhej nëpërmjet urdhërpaguesave nga jashtë sistemit tatimor, pasi kjo përgjegjësi nuk ishte e formalizuar nëpërmjet një deklarate tatimore. Pagesa nga ana e subjekteve kryhej në total, për të gjitha detyrimet e lindura për një periudhë tatimore të caktuar në lidhje me “tatimin në burim” dhe, si e tillë, detajimi i çdo pagese të kryer nga ana e subjektit mbetet përgjegjësi e tij. Për sa më lart, në lidhje me kërkesën tuaj, na nevojitet detajim nga ana e subjektit deklarues të çdo pagese të kryer për secilën periudhë tatimore, së cilës i referoheni në shkresën tuaj, për të vijuar më pas në përputhjen e totalit të pagesave të kryer nga tatimpaguesi dhe regjistruar nga Administrata Tatimore”.

(3) Me shkresën nr. {***} prot., datë 22.09.2023, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan, ka bërë me dije se: “Në lidhje me subjektin {***}, me nr. NIPT {***}, i regjistruar në organin tatimor me datë 17.05.2000, aktualisht i çregjistruar më datë 16.12.2010 dhe, nga verifikimi në sistemin tatimor c@ts, subjekti nuk ka deklaruar apo paguar tatimin e mbajtur në burim për të ardhurat nga marrëdhëniet kontraktuale të shërbimit, ku duhet të theksojmë se, sipas të dhënave në sistemin tatimor c@ts, subjekti rezultoi të jetë regjistruar vetëm për përgjegjësitë tatimore ‘Tatim mbi vlerën e shtuar’ dhe ‘Tatim mbi fitimin’, dhe ka deklaruar në DRT Elbasan deri në periudhën mars 2001 dhe, mbas kësaj periudhe, pranë DRT Elbasan, nga ana e subjektit, nuk ka deklarime dhe pagesa, si dhe konkretisht, pagesa për tatimin e mbajtur në burim”.

⁶ Komisioni iu drejtua me shkresat nr. {***} prot., datë 25.07.2023, dhe nr. {***} prot., datë 01.09.2023, shoqërisë “{***}” SHPK, nga e cila nuk u kthye përgjigje.

“{***}” ShPK, të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale për periudhën 2005 – 2010, si dhe ka paraqitur vërtetimin e datës 09.10.2023 të kësaj gjykate, që provon veprimin e kryer për dorëzimin e padisë. Në përfundim, subjekti ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit për të mos përfshirë këto të ardhura në analizë financiare, për arsye se gjendet në pamundësi për të provuar pagesën e tatimit në burim, nuk është në përputhje me standardin e aplikuar nga Kolegji në raste të ngjashme.

15.9. Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit mbi të ardhurat e pretenduara nga bashkëshorti dhe marrëveshja e lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK apo “{***}” ShPK nuk janë bindëse, dhe nuk i ka përfshirë ato në analizë financiare. Në vlerësimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve tatimore, sipas kritereve ligjore të përcaktuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues lidhur me shërbimet dhe punët e kryera nga bashkëshorti për këtë shoqëri ndër vite.

15.10. Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, nuk e pretendoi asnjëherë mos dijeninë e pagesës së tatimit për të ardhurat. Lidhur me pretendimin e subjektit se detyrimin për pagimin e tatimit e ka pasur shoqëria, Komisioni konstaton se subjekti synon të ligjërohen, në kuptim të ligjit, të gjitha të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti prej këtij shërbimi (të ardhurat që duhej t'i nënshtroheshin regjimit tatimor në fuqi), ndërsa ky fakt nuk provohet se ka ndodhur, pasi bashkëshorti i subjektit ka zgjedhur vetë të mos regjistrohet në organet tatimore për të ushtruar aktivitetin si person fizik (avokat). Pra, mosregjistrimi si person fizik dhe shmangia e detyrimeve tatimore për këtë aktivitet, duket se është bërë me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga marrëveshja me shoqërinë “{***}” ShPK, e cila duket se i ka shërbyer të dyja palëve kontraktore. Komisioni mban në konsideratë faktin se bashkëshorti i subjektit ishte subjekt deklarues që prej vitit 2005 dhe, si i tillë, ai është sjellë, të paktën me neglizhencë të pajustificuar, drejt legjitimitetit të të ardhurave të tij, në kuptim të zbatimit të legjislacionit tatimor. Të gjitha shkaqet dhe rrethanat e trajtuara më sipër kanë krijuar bindjen e Komisionit se personi i lidhur me subjektin ka pasur dijeni të plotë për mungesën e pagimit të detyrimit tatimor dhe është pajtuar me këtë situatë në një periudhë kohe të gjatë dhe të shpeshtë të ushtrimit të këtij aktiviteti.

15.11. Trupi gjykues i Kolegjit, në vlerësim të shkaqeve të ankimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar se, për periudhën 2005 – 2010, bashkëshorti ka siguruar të ardhura nga shërbimet e konsulencës me shoqërinë “{***}” ShPK, në vlerën 73.000 euro, të cilat përkrijnë me vlerën dhe periudhën e deklaruar nga shoqëria “{***}” ShPK në deklaratën me nr. {***} prot., të datës 07.01.2017, si akt i provues, paraqitur bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*.

15.12. Këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore respektive, në të cilat për vitet 2009 – 2010, janë deklaruar me përshkrimin “*Të ardhura të prapambetura nga ‘{***}’ ShPK*”. Në jurisprudencën e Kolegjit, është trajtuar gjerësisht vlera provuese e deklaratave periodike vjetore në këtë proces, në drejtim të përcaktimit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimeve të subjekteve në deklaratën e pasurisë *vetting*, të cilat, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë mbi kriterin e kontrollit të pasurisë.

15.13. Në funksion të këtyre deklarimeve, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka paraqitur “*Marrëveshje bashkëpunimi*”, datë 15.08.2005, lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe bashkëshortit, e vlefshme për një periudhë 3-vjeçare, në pikën 7 të së cilës parashikohet se, shoqëria merr përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit shqiptar, që rrjedhin nga pagimi i këtij

shpërblimi, konform legjislacionit në fuqi. Po ashtu, subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka paraqitur edhe “*Marrëveshje për shlyerje detyrimesh në të holla*”, datë 14.05.2009, lidhur midis bashkëshortit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, sipas së cilës, shoqëria, në referencë të shërbimeve ligjore të kryera prej tij, sipas “*Marrëveshje bashkëpunimi*”, datë 15.08.2005, i njej këtij të fundit detyrimin e papaguar në vlerën prej 19.000 eurosh, detyrim i cili do të shlyhet i ndarë në dy pjesë: 12.000 euro në vitin 2009 dhe 7.000 euro në vitin 2010.

15.14. Nga shqyrtimi i llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit në Intesa Sanpaolo Bank ShA, rezulton se, gjatë viteve 2005 – 2010, në këtë llogari, shoqëria “{***}” ShPK ka kredituar në total, vlerën prej 73.000 euro.

15.15. Në vijim të komunikimeve të përsëritura të Komisionit me organet tatimore, Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) ka informuar se: *[...] Në lidhje me tatimin e lindur për të ardhurat e shtetasit M. M. [...] nga marrëdhënia kontraktuale me subjektin në administrim të DTM, “{***}”, me NIPT {***}, për periudhën [...] 2005 – 2010 [...] pagesa nga ana e subjekteve kryhej në total për të gjitha detyrimet e lindura për një periudhë tatimore të caktuar në lidhje me tatimin në burim dhe, si e tillë, detajimi i çdo pagese të kryer nga ana e subjektit mbetet përgjegjësi e tij.”*

15.16. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, rezultoi se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në vijim “Gjykata”), me vendimin nr. {***}, datë 01.03.2024, (lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. {***}, datë 11.12.2024), ka njohur detyrimin e palës së paditur, shoqërisë “{***}” ShPK, për të paguar tatimin mbi të ardhurat mbi vlerën 73.000 euro, si detyrim që rrjedh nga “*Marrëveshja e Bashkëpunimit*”, datë 15.08.2005, dhe “*Marrëveshja për shlyerjen e detyrimit*”, datë 14.05.2009. Gjykata, për zgjidhjen e çështjes në themel, ka vlerësuar natyrën e marrëdhënies juridike të krijuar midis palëve, duke analizuar nëse marrëveshjet objekt gjykimi plotësojnë kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, sipas parashikimeve të nenit 663 të Kodit Civil. Nisur nga objekti i “*Marrëveshjes së bashkëpunimit*” datë 15.08.2005, Gjykata ka vlerësuar se jemi para një kontrate të zakonshme shërbimi, e lidhur midis palëve për ofrimin e shërbimit juridik, e cila plotëson kushtet e nevojshme për lidhjen e saj, të cilat janë të vlefshme e korrekte me legjislacionin në tërësi.

Nga kontrolli gjyqësor që i është bërë padisë së personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, është vlerësuar se: *[...] bazuar në legjislacionin në fuqi, pala e paditur, shoqëria “{***}” ShPK, kishte detyrimin ligjor për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale mbi shumën 73.000 euro, të përfituara nga pala paditëse, bazuar në “*Marrëveshjen e Bashkëpunimit*”, si dhe detyrimin ligjor që të provojë se e ka paguar këtë detyrim në favor të administratës tatimore, sikundër e ka marrë përsipër me marrëveshjen e datës 15.08.2005. Përveç detyrimit ligjor, edhe në kontratën e lidhur, pala e paditur ka marrë përsipër pagimin e detyrimeve financiare. Sipas pikës 7 të Marrëveshjes, shoqëria “{***}” ShPK, merr përsipër të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit shqiptar, që rrjedhin nga pagimi i këtij shpërblimi, konform legjislacionit në fuqi. [...]. Me shkresën nr. {***} prot., datë 19.03.2025, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, konfirmohet ekzekutimi i këtij detyrimi sipas vendimit të sipërcituar të gjykatës.*

15.17. Trupi gjykues, në përmbledhje të situatës faktike të këtij shkaku ankimi, çmon se, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Komision dhe në Kolegj, subjekti provoi bindshëm ekzistencën e këtyre të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, të evidentuara në llogaritë bankare të bashkëshortit gjatë viteve 2005 – 2010, të deklaruara nga subjekti edhe në deklaratat periodike vjetore të kohës, të cilat përbëjnë një burim prove të rëndësishëm në këtë proces. Vlera dhe burimi i këtyre të ardhurave të deklaruara

nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* u provuan se vijnë nga *Marrëveshja e bashkëpunimit*, datë 15.8.2005 dhe *Marrëveshja për shlyerje detyrimesh në të holla*, datë 14.5.2009, lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Këto marrëveshje, nga trupi gjykues, u konsideruan me vlerë provuese në drejtim të: (i) formalizimit të marrëdhënies së shërbimit të konsulencës së bashkëshortit të subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK; (ii) njohjes së detyrimeve të prapambetura nga kjo marrëdhënie; si dhe (iii) përcaktimit të përgjegjësisë ligjore mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e siguruara nga kjo marrëveshje.

15.18. Qëndrimi i trupit gjykues përforcohet në kushtet kur, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, u provua që gjykata, me vendim të formës së prerë, bazuar në marrëveshjet e sipërcituara, datë 15.08.2005 dhe 14.05.2009, ka zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen midis palëve, sa i përket përgjegjësisë ligjore për pagesën e detyrimeve tatimore, dhe pasojat ligjore të këtij detyrimi në organet tatimore. Kolegji, në jurisprudencën e tij ka konfirmuar qëndrimin se, për sa kohë që të ardhurat: (i) janë deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike; (ii) provohet se ekzistojnë dhe vijnë nga një burim i ligjshëm; (iii) përgjegjësia ligjore për shlyerjen e detyrimeve tatimore lidhur me to, i përket një subjekti tjetër, dhe (iv) nuk provohet se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në keqbesim në lidhje me mospagimin e detyrimeve tatimore, ato kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, këto të ardhura u përfshinë në analizë financiare, në mesin e të ardhurave të ligjshme.

B/2 Lidhur me deklarimin e gjendjes cash

16. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me gjendjen *cash* në deklaratat periodike vjetore, në raport edhe me gjendjen *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe është munduar të shfaqë në mënyrë të pasaktë faktet dhe rrethanat lidhur me deklarimet e bëra, sa i përket gjendjes *cash* ndër vite.
17. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, pretendon se ky vlerësim i Komisionit nuk i përgjigjet realitetit, dhe kërkon të konsiderohet si i pabazë. Provat e sjella nga subjekti ndryshojnë nga ato të administruara nga Komisioni, për faktin se, në praktikën e atyre viteve, për shkak se mungonte eksperiencia, për deklarimet e para, që u kryen pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, mund të bëheshin korrigjime në momentin e dorëzimit të tyre. Subjekti pretendon se dokumentet e depozituara nga ana e saj në Komision janë përdorur gabimisht dhe nuk kanë vlerë juridike, pasi janë thjesht kopje, pa asnjë vlerë provuese.
18. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të administruara në fashikuj dhe pretendimeve të subjektit në ankim dhe parashtrime, konstaton dhe vlerëson si vijon:

18.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete në gjendje *cash* në banesë.

18.2. Në DPIV – 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë gjendje *cash*, “*Shtesë cash në shumën 300.000 lekë, nga të ardhura*”, si dhe ka vijuar të deklarojë shtesa/pakësime të gjendjes *cash* deri në vitin 2013⁷. Pas këtij viti, subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*. Në DIPV-

⁷ Në DPIV-në e vitit 2006 ka deklaruar shtesë në *cash* në shumën 500.000 lekë; në DPIV / 2007 ka deklaruar pakësim në *cash* – 800.000 lekë; Në DPIV / 2008 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë 47.000 euro; në DPIV / 2009 ka deklaruar pakësim *cash* 11.000 euro (pagesë shkollimi djali) – 15.000 CAD (dollarë kanadezë); në DPIV / 2010 ka deklaruar

në e vitit 2008, subjekti deklaroi për herë të parë kursime *cash* në monedhën euro, konkretisht 47.000 euro.

18.3. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë gjithashtu subjekt deklarues në vitet 2003 – 2005, dhe ka deklaruar gjendjen *cash*, si vijon: - (1) Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, ai ka deklaruar *gjendje cash 0.8 milion lekë*; (2) Në DPIV-në e vitit 2004, ka deklaruar *pakësim cash* në vlerën *500.000 lekë*; (3) Në DPIV-në e vitit 2005, nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*.

18.4. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, sa i përket mospërputhjeve me deklaratimet mbi gjendjen *cash* për vitet 2003 – 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] në DPIV-në e vitit 2004, nga ana ime, gabimisht janë deklaruar vetëm të ardhurat e siguruar nga puna ime si gjyqtare. Deklarimi i bashkëshortit në DPIV-në e vitit 2004 është më i plotë, duke u deklaruar të ardhurat nga puna e të dy bashkëshortëve, si dhe shtesa në likuiditete në llogarinë e tij pranë Credins Bank, gjendje në shumën 500,000 lekë. Për vitin 2005, bashkëshorti ka plotësuar dhe dorëzuar pranë ILDKPKI-së formularin e largimit nga detyra, datë 27.09.2005, duke mos cilësuar gjendje *cash* në këtë moment. Për rrjedhojë, gjendja *cash* në shumën 300.000 lekë, deklaruar nga ana ime në DPIV-në e vitit 2005, pasqyron kursimet e realizuara përgjatë gjithë vitit të deklaratimit. Pasaktësitë si më sipër, janë pasojë e mosnjohjes së procesit të deklaratimit në fazat e tij fillestare. [...].*

18.5. Komisioni, në analizën financiare, ka pasqyruar gjendjen *cash* (shtesa dhe pakësime) në vitet 2003 – 2004, sipas deklaratimeve të bashkëshortit të subjektit dhe, në vitin 2005, është pasqyruar gjendja *cash* në vlerën 300.000 lekë, e deklaruar nga subjekti. Gjithashtu, nisur nga fakti se subjekti, në deklaratat periodike të viteve 2014 – 2016, nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*, gjendja progresive e fundvitit 2013, prej 2.800 eurosh + 260 euro, është konsideruar si e pandryshuar deri në vitin 2016 në analizën financiare të Komisionit. Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ndër të tjera, ka konstatuar se: (i) *ka pasaktësi në deklaratim të gjendjes cash nga subjekti në DPV-të e viteve 2003 – 2005, në raport me deklaratimet e bashkëshortit të saj në DPV-të e këtyre viteve*; (ii) *Subjekti ka bërë deklarime të pasakta në deklaratat periodike vjetore, si dhe nuk ka deklaruar ndryshimet e gjendjes cash në DPV-të e viteve 2014 e në vazhdim*; (iii) *Ka mospërputhje me deklaratimin e gjendjes cash në vetting me gjendjen cash në deklaratat periodike vjetore.*

18.6. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, ka deklaruar se ajo dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar gjendje *cash* në DPIV-në e vitit 2003. Konstatimi i Komisionit se, në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2003, bashkëshorti ka deklaruar gjendje *cash 0.8 milion lekë*, është i paqartë dhe nuk rezulton të jetë pjesë e deklaratës së personit që mbart detyrim për deklaratim pasurie, e cila është depozituar në datën 18.03.2004 në ILDKPKI. Për vitin 2004, bashkëshorti ka deklaruar në DPIV-në respektive, gjendje *cash* në llogarinë e pagës Credins Bank, ShA, shumën 500.000 lekë. Sipas subjektit, dokumentacioni që disponon, kopje e DPIV-së së bashkëshortit, e vitit 2004, nuk ka asnjë përshkrim lidhur me pakësimin e gjendjes *cash*, ndaj, është e pamundur të japë shpjegime për një situatë të tillë, duke u shprehur se, nëse konkluzioni vjen nga dokument tjetër që nuk e disponon, t'i vihet në dispozicion, në mënyrë që të japë qëndrimin e nevojshëm. Subjekti shpjegon se në DPIV-në e vitit 2004, gabimisht nuk është deklaruar prej saj shtesa e gjendjes *cash* në llogarinë e pagës së bashkëshortit, pranë Credins Bank, në shumën 500.000

pakësim të gjendjes cash në shumën 3.100 euro; në DPIV / 2011 ka deklaruar pakësim cash në shumën 14.900 euro (për shpenzime shkollimi të djalit dhe jetesës); në DPIV / 2012 ka deklaruar pakësim cash në shumën 15.200 euro. Gjendje, shuma prej 2.800 euro. Në DPIV-në e vitit 2013 ka deklaruar shtesë likuiditeti – kursime nga të ardhurat personale të vitit 2013, në vlerën 260 euro. Pra, sipas kësaj deklarate periodike, subjekti dispononte në vitin 2013 gjendje cash 2.800 euro + 260 euro.

lekë. Ndërkohë, deklaratimet e tjera janë të sakta, përjashtuar ndryshimet me deklaratimet e bashkëshortit për vitet 2003 – 2005, të cilat pretendon se nuk rezultojnë të provuara në dokumentacionin që disponon. Deklarimet për mungesën e gjendjes *cash* në banesë në vitet 2014 – 2016 janë tërësisht të sakta. Në funksion të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kopje të deklaratave të interesave privatë që i përkasin viteve 2003 – 2004, si dhe kopje të deklaratës së bashkëshortit, pas largimit nga funksioni të datës 27.09.2005.

18.7. Komisioni në vendim ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit, në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, është munduar të paraqesë fakte dhe prova në kundërshtim me formularët e pasurisë dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë ILDKPKI-së ndër vite. Kopja e deklaratës së vitit 2003, e paraqitur nga subjekti (te formulari A5, “Likuiditete”), nuk përmban shënime lidhur me gjendjen *cash* në banesë, e cila ndryshon me deklaratën e paraqitur nga ILDKPKI-ja pranë Komisionit. Sipas deklaratës së paraqitur nga ILDKPKI-ja (deklarata e datës 18.03.2004), rezulton se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar gjendje *cash* 0.8 milion lekë, me burim kursime nga të ardhurat. Po ashtu, kopja e deklaratës së vitit 2004, e paraqitur nga subjekti, nuk përmban shënime lidhur me ndryshimin e gjendjes *cash* në banesë, e cila ndryshon me deklaratën e paraqitur nga ILDKPKI-ja, në të cilën rezulton se bashkëshorti ka deklaruar *pakësuar cash në shumën 500.000 lekë*.

18.8. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ dhe shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, në konsekuencë edhe të qëndrimeve tashmë të konsoliduara të mbajtura nga Kolegji në jurisprudencën e tij, vlerëson se pasaktësitë në deklaratimet periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të shërbejnë si shkelje të tilla, të cilat të formojnë bazën e duhur ligjore për masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

18.9. Nga analizimi i deklaratimit të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për vitet 2003, 2004 dhe 2005, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të pasaktë, i cili vjen si pasojë e mospërputhjes ndërmjet deklaratimeve të subjektit dhe deklaratimeve të personit të lidhur, bashkëshortit të saj, por nga ana tjetër, referuar gjendjes *cash* të deklaruar dhe analizës financiare të kryer, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë në pamundësi financiare për të krijuar këto kursime. Për rrjedhojë, këto mospërputhje janë pa pasojë në procesin e rivlerësimit të subjektit, pasi, edhe në konsideratë të alternativës së konsiderimit të gjendjes *cash*, të deklaruar nga bashkëshorti për vitet 2003, 2004 dhe 2005, subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me mundësi financiare për ta krijuar atë, si dhe për të mbuluar shpenzimet dhe investimet në këtë periudhë. Trupi gjykues i vlerëson të besueshme dhe shteruese shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ mbi dinamikën e hartimit të deklaratave periodike vjetore nga bashkëshorti, duke mbajtur në konsideratë faktin se këto akte nuk u depozituan nga subjekti i rivlerësimit me qëllim, për të justifikuar pamjaftueshmërinë financiare të rezultuar, apo me synimin e pasqyrimin të një situatë financiare të ndryshme nga ajo e deklaruar.

18.10. Në këto kushte, kur pasaktësitë në deklarime në vitet e para të plotësimit të deklaratave të pasurisë për gjendjen e *cash-it* nga ana e subjektit dhe personit të lidhur nuk shoqërohen me pamundësi financiare për krijimin e tij, ato nuk mund të konsiderohen se janë paraqitur për të shtrembëruar faktet dhe provat shkresore e të trajtohen si veprime që cenojnë figurën e magjistratit. Trupi gjykues vlerëson se kjo rrethanë nuk ka elementet e mjaftueshme për ta konsideruar si shkak shkarkimi, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

19. Komisioni ka vlerësuar se subjekti është përpjekur të fshehtë dokumentacionin e kërkuar lidhur me veprimet bankare të kryera nga djali i saj në Kanada, duke mos e vënë atë të plotë në dispozicion gjatë hetimit administrativ, në mënyrë që të mundësonte kryerjen e një analize të plotë financiare lidhur me shpenzimet e kryera në këtë llogari bankare. Këtë fakt, Komisioni e ka mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë dhe çështjes.
20. Subjekti i rivlerësimit, në ankim ka pretenduar se Komisioni për të arritur në këtë konkluzion, i referohet vetëm faktit që subjekti nuk ka mundur të sigurojë informacion të plotë për llogarinë e djalit të saj pranë Royal Bank of Canada (në vijim “RBC”) në Kanada, që i përket periudhës shtatë vite përpara se t’i kërkohej nga Komisioni. Konkluzioni i Komisionit, i cili përdor si argument faktin që, në vitin 2017, subjekti ka depozituar si provë për pagesën e qirasë së djalit pjesë të *statement*-it bankar për vitet 2014 dhe 2015, dhe se kjo nënkupton disponimin e *statement*-it të plotë të këtyre viteve, sipas subjektit, është tërësisht paradoksal. Në vlerësimin e subjektit, çdo konkluzion i kësaj natyre është thjesht tejkallim i kompetencave ligjore, me qëllim rëndimin e pozitës së subjektit. Në shkaqet e ankimit, subjekti pretendon se shpenzimet e jetesës së djalit në Kanada kanë qenë bazike dhe nuk e kanë kaluar vlerën 515 CAD (*dollarë kanadezë*) në muaj.
21. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të administruara në fashikuj dhe pretendimeve të subjektit në ankim, konstaton dhe vlerëson si vijon:
- 21.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, djali i subjektit ka deklaruar shpenzime si bashkëqiramarrës në një banesë të ndodhur në adresën: “{***}, Canada”, me vlerë mujore të përgjithshme qiraje 1.800 CAD, me pjesë takuese në vlerën 600 CAD. PAGESA është deklaruar se paguhet nga prindërit.
- 21.2. Në DIPV-të 2011 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime shkollimi të djalit në Kanada, të cilat Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare, në vitet respektive.
- 21.3. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se djali, L. M., në muajin gusht 2010, është larguar nga banesa familjare, për të ndjekur studimet në Vankuver, Kanada. Gjatë kohës së qëndrimit në këtë qytet, ai ka banuar në disa ambiente të ndryshme⁸. Nga muaji nëntor 2014 deri në 1 shtator 2016, djali është strehuar në një dhomë pranë “{***}” (strukturë akomoduese me dy yje), e ndodhur në adresën: {***}. Për gjithë kohën e qëndrimit të tij në këtë ambient, është dakordësuar një tarifë e pandryshuar, e cila i është paguar hotelit për çdo muaj, *nëpërmjet transfertave bankare, sikurse vërtetohet nga kopje e dokumenteve të bankës RBC, të nxjerra nga llogaria e djalit, të cilat do t’i gjeni bashkëlidhur*. Subjekti ka depozituar ekstrakt të llogarisë bankare të djalit, që i përket periudhës nga 17.10.2014 – 18.11.2014 dhe në vijim, nga data 18.12.2014, ka paraqitur pasqyra të llogarisë bankare muaj për muaj, deri në datën 18.01.2017.
- 21.4. Komisioni, me pyetësorin nr. 3, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë të

⁸ Subjekti ka deklaruar se: “Nga viti 2010 deri në vitin 2013, djali ka studiuar në shkollën {***}, Canada. Për këtë periudhë shkollimi është paguar vetëm tarifa e studimit, pasi shpenzimet e jetesës - akomodimit dhe ushqimit të tij, janë mbuluar nga motra e bashkëshortit dhe familja e saj. Komisionit i ka rezultuar me mundësi financiare motra e bashkëshortit për të mbuluar shpenzimet gjatë kësaj periudhe. Tarifa e studimit ka qenë 15.000 CAD për vit shkollor. Këto pagesa janë kryer nëpërmjet transfertës bankare. Burimi i financimit i të gjitha shpenzimeve të shkollimit për këtë periudhë, kanë qenë të ardhurat familjare nga puna në vite. Gjatë viteve 2013 – 2017, djali ka kryer studimet universitare, në Universitetin e British Kolumbia - UBC, Canada. Për vitin kalendarik 2013, është paguar në total shuma 16.659 CAD. Për vitin kalendarik 2014, është paguar në total shuma 24.358 CAD. Në këtë vit kalendarik, një shumë prej 3.000 CAD, pjesë e tarifës për akomodim dhe ushqim, është financuar nga motra e bashkëshortit. Për vitin kalendarik 2015, është paguar në total shuma 30.005 CAD. Për vitin kalendarik 2016, është paguar në total shuma 30.633 CAD”.

dokumentuara të gjitha llogaritë bankare në emër të djalit jashtë Shqipërisë dhe *statement*-et bankare të këtyre llogarive me të gjitha faqet që nga momenti i krijimit deri në datën e pyetësorit. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka deklaruar se: [...] *Djali L. M., në tetor 2013, ka çelur një llogari rrjedhëse pranë Royal Bank of Canada, me nr. {***}, si dhe një llogari kursimesh pranë të njëjtës bankë, me nr. {***}, llogari të cilat vijon t'i disponojë edhe aktualisht. Pas kërkesës tuaj, djali i është drejtuar bankës me kërkesë për të tërhequr statement-e bankare për gjithë periudhën që kërkohet. Ndërkohë që jemi në pritje të përgjigjes, ju bëj me dije se për periudhën 2016 – 2023, një informacion mund të aksesohet online. Informacioni online është i kufizuar vetëm për këtë periudhë dhe nuk përfshin pjesën e mbetur, tetor 2013 – janar 2016. Sa më sipër, bashkëlidhur do të gjeni statement-e bankare vetëm për periudhën 2016 – 2023, ndërkohë që jemi në pritje të përgjigjes për pjesën tjetër të dokumentacionit, e cila do t'ju vihet në dispozicion sapo të jepet nga Banka. [...]. Në funksion të përgjigjeve, subjekti paraqiti kopje të llogarisë bankare, për periudhën 2016 – 2023, si dhe komunikimin e datës 23.06.2023 të djalit të subjektit me bankën, në të cilën i kërkon ekstraktin e llogarisë nga data e hapjes në vitin 2013 dhe aktualisht. Nga përgjigja e administruar në formë elektronike, e së njëjtës datë, personi me të cilin djali ka komunikuar (*banking advisor*) ka referuar se: “Nuk jemi në gjendje të ofrojmë deklarata bankare që shkojnë përtej një periudhe më të gjatë se 7 vite para nga dita e sotme. Të gjitha deklaratat bankare që shkojnë përtej kësaj periudhe mund t'i gjeni nëpërmjet online banking”.*

21.5. Komisioni, me rezultatet e hetimit, i njoftoi subjektit rezultatet e analizës financiare, mbi mundësinë e subjektit dhe bashkëshortit për mbulimin e shpenzimeve të djalit në Kanada me të ardhura të ligjshme, si dhe i kërkoi sërish subjektit të paraqesë dokumentacionin e plotë të llogarive bankare të djalit në Kanada, që nga momenti i krijimit të tyre e në vazhdim.

21.6. Në prapësimet e rezultateve të hetimit, subjekti ka bërë një saktësim në analizë financiare sa i përket shpenzimeve të jetesës së djalit në Kanada për vitet 2015 dhe 2016, ndërsa sa i takon kërkesës për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të llogarive bankare, subjekti ka depozituar edhe një herë komunikimin elektronik të djalit, me përfaqësues të bankës RBC, të cilët i janë përgjigjur se nuk mund të sigurojnë deklarata bankare që shkojnë përtej një periudhe më të gjatë se 7 (shtatë) vite.

21.7. Komisioni, në vijim, nuk e konsideroi të vërtetë faktin se subjekti është në pamundësi për të vënë në dispozicion të dhënat bankare për veprimet e kryera nga personi i lidhur, djali i saj, para viteve 2016, pasi ajo nuk provoi përmbushjen e kërkesave ligjore të nenit 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016. Në përgjigje të pyetësorit standard të dërguar nga Komisioni, subjekti ka paraqitur si provë, për të vërtetuar pagesat e qirasë së djalit, pjesë të *statement*-it bankar të RBC, që datojnë nga data 17.11.2014 deri në gusht të vitit 2016, por nuk ka vënë në dispozicion *statement*-in e plotë lidhur me veprimet e kryera në këtë llogari bankare nga ana e djalit të saj. Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka pasur në dispozicion kopje të plotë të *statement*-it lidhur me llogarinë bankare të djalit të saj pranë RBC, por nuk e ka vënë të plotë në dispozicion të Komisionit, në mënyrë që të mundësonte kryerjen e një analize të plotë financiare lidhur me shpenzimet e kryera në këtë llogari bankare.

21.8. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, djali i saj, ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* shpenzime si bashkëqiramarrës në një banesë në Kanada, me vlerë mujore të përgjithshme qiraje 1.800 CAD, me pjesë takuese në vlerën 600 CAD, e deklaruar se paguhet nga prindërit. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike vjetore të vitit 2011

– 2016⁹, ka deklaruar shpenzimet e shkollimit të tij për këto vite në Kanada, duke i mundësuar institucioneve të rivlerësimit kontrollin dhe analizimin e tyre në drejtim të përcaktimit të mundësisë financiare të subjektit dhe personit të lidhur, për t’i justifikuar ato me të ardhura të ligjshme.

21.9. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, të kryer në Kolegj nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, duke llogaritur shpenzimet e jetesës për një person në Kanada për vitet 2014, 2015 dhe 2016, sipas publikimit të faqes së statistikave në Kanada,¹⁰ për shpenzimet për shkollim dhe ato të qirasë, të kryera për periudhën që djali i subjektit ka jetuar më vete, rezultoi një balancë negative prej (-) 485.287 lekësh, e cila e shpërndarë në disa vite, është e pamjaftueshme për t’u konsideruar si një shkak më vete për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra. Nga sa më sipër, pamundësia e subjektit të rivlerësimit që gjatë procesit administrativ të vinte në dispozicion të dhënat bankare të djalit, si person i lidhur për periudhën janar 2014 – tetor 2014, me gjithë përpjekjet e bëra për të siguruar dokumentacionin bankar, në vlerësim të trupit gjykues, nuk ka elementët e mjaftueshëm për t’u mbajtur në konsideratë si qëndrim i subjektit, që duhet trajtuar në vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë apo çështjes në tërësi.

22. Në përfundim të kontrollit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, nga kontrolli në Kolegj i analizës financiare të Komisionit për periudhën e rivlerësimit, në vlerësim të akteve në fashikull dhe për sa arsyetuar më lart mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga shërbimet e konsulencës të personit të lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej (-) 954.531 lekësh. Në këtë analizë, u përfshinë të ardhurat e realizuara nga shoqëria “{***}” ShPK, si dhe të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit të subjektit, në masën që u provua pagesa e detyrimeve tatimore lidhur me to. Trupi gjykues, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit dhe në konsideratë të faktit se kjo vlerë shpërndahet në disa vite në vlera jo domethënëse, vlerëson se balanca negative nuk është e mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

C/1 Lidhur me konstatimet mbi tejkalimin e afateve të gjykimit të çështjeve

23. Komisioni, në analizë të dhënave të raportit të vlerësimit të aftësive profesionale, hartuar nga KLGJ-ja dhe denoncimeve të administruara gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se çështjet e trajtuara nga subjekti në: (i) 3 (tre) dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë ajo, (ii) në dosjen e listuar me nr. 4, nga 5 (pesë) dosjet e shortuara, si dhe (iii) në 6 (gjashtë) denoncime, ka vepruar duke zgjatur tej afatit të arsyeshëm 6-mujor, të përcaktuar në pikën 5, shkronja “e” e Aneksit nr. 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, duke arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi të theksuara në mënyrë të përsëritur në lidhje me afatet e gjykimit të çështjeve.

⁹ Në DIPV- 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësim të gjendjes së cash-it, për pagesën e shkollimit të djalit në shumën 15.000 CAD; Në DIPV – 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagesë për shkollimin e djalit të saj në shumën 15.000 CAD; Në DIPV – 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e shkollimit të djalit të saj në shumën 15.000 CAD; Në DIPV – 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e shkollimit të djalit të saj në shumën 18.457 CAD; Në DIPV – 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e shkollimit të djalit të saj në shumën 30.500 CAD; Në DIPV – 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e shkollimit të djalit të saj në shumën 31.000 CAD; DIPV – 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e shkollimit të djalit të saj në shumën 30.000 CAD.

¹⁰ <https://www150.statcan.gc.ca/t1/tb11/en/cv.action?pid=1110022401>

24. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim se Komisioni ka konstatuar të njëjtën problematikë, zgjatjen e gjykimit tej afatit të arsyeshëm. Ky konkluzion, shprehet subjekti, në pamje të parë është i drejtë, por sikurse ka mbajtur qëndrim gjatë hetimit administrativ, si dhe në seancën dëgjimore në Komision, këto konstatime reflektojnë pamundësinë e zhvillimit të seancave normale, për shkak të marrjes së provave dhe qëndrimit të palëve, apo problematikave të tjera procedurale, që pamundësojnë përfundimin e gjykimit brenda afatit ligjor. Në vijim të sa më sipër, subjekti pretendon:

24.1. Edhe pse është në dijeni të faktit se dokumentet e përzgjedhura nga subjekti janë tej afatit 6-mujor, ajo i ka përcjellë në drejtim të vlerësimit të kompleksitetit dhe cilësisë së vendimmarrjes, të konfirmuara dhe nga Gjykata e Apelit. Komisioni nuk ka vlerësuar pamundësinë e zhvillimit të seancave për shkak të marrjes së provave dhe qëndrimit të palëve apo problematika të tjera procedurale. Në të tri këto gjykime, asnjë prej seancave nuk është shtyrë për mungesën e gjyqtarit. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013, kanë mbajtur qëndrim për faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e një gjykimi, faktorë të cilët janë vërejtur edhe në çështjet në fjalë.

24.2. Për gjetjet e dosjes të shortuar me nr. 4, subjekti ka pretenduar se afati nga seanca në seancë, ka qenë i kushtëzuar nga ngarkesa e lartë e çështjeve në gjykim dhe në asnjë rast për shkak të neglizhencës në punë. Nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi elektronik i gjykatës, rezulton se të gjitha shtyrjet kanë qenë të arsyetuara dhe në respektim të përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile, me kërkesë të palëve, apo me qëllim sigurimin e provës me ekspert, me dëshmitarë, etj., duke siguruar në këtë mënyrë, kryerjen e një hetimi të plotë dhe zgjidhjen e drejtë dhe ligjore të çështjes, konfirmuar edhe nëpërmjet vendimmarrjes së shkallëve të tjera të gjykimit.

24.3. Për vonesat e konstatuara në trajtimin e denoncimeve, subjekti pretendon se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e saj. Sikurse ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ afati nga seanca në seancë, në më të shumtën e rasteve ka qenë i determinuar nga ngarkesa e lartë e çështjeve në gjykim, dhe në asnjë rast nga qëndrimi subjektiv i gjyqtarit për zvarritje të qëllimshme të gjykimit apo për shkak të neglizhencës.

25. Trupi gjykues i Kolegjit, nga verifikimi i akteve të dosjeve gjyqësore, lidhur me çështjet e gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat ka rezultuar në tejkalim të afateve të gjykimit, jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vëren se edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit në shkaqet e ankimit dhe në parashtrime, mbeten të konfirmuara tejkalimet e afatit në këto çështje: (i) 3 (tre) dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit¹¹; (ii) në dosjen e listuar nr. 4, nga 5 dosjet e shortuara¹², si dhe (iii) në analizë

¹¹ (i) Për dokumentin nr. 1 (Me termin “Dokument”, u referohemi dokumenteve të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016), kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 13 muaj e 4 ditë; (ii) për dokumentin nr. 2, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 12 muaj e 17 ditë; (iii) për dokumentin nr. 3, kohëzgjatja e këtij gjykimi ka qenë rreth 16 muaj; jashtë afatit 6-mujor, të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit nr. 1 të Sistemit të Vlerësimit.

¹² Në dosjen nr. 4, kohëzgjatja e këtij gjykimi ka qenë 12 muaj e 3 ditë, jashtë afatit 6-mujor, të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit nr. 1 të Sistemit të Vlerësimit.

të 6 (gjashtë) denoncimeve, konkretisht të shtetasve A. S.,¹³ A. H.,¹⁴ H. A.,¹⁵ D. M.,¹⁶ E. R.¹⁷ dhe J. V.¹⁸ Kolegji, në jurisprudencën e tij, ka arsyetuar se gjetjet në drejtim të tejkalimit të afatit të gjykimit prej 6 muajsh, i cili përbën një afat orientues, nuk mund të marrin peshë e të sjellin efekte në drejtim të vlerësimit të efektivitetit dhe produktivitetit të një gjyqtari, nëse ato nuk merren në shqyrtim dhe vlerësohen në kompleks, në harmoni dhe në raport edhe me indikatorët e tjerë të përcaktuar sipas këtij sistemi vlerësimi.

25.1. Nga analizimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore të çështjeve të sipërcituara, rezultoi se ato kryesisht janë shtyrë për shkaqe të kërkesave procedurale të palëve ndërgjyqëse dhe arsye objektive, por, janë caktuar në intervale kohore të konsiderueshme larg nga njëra tjetra. Në konsideratë të pretendimeve të subjektit lidhur me ngarkesën në punë, referuar të dhënave statistikore të përshkruara në raportin profesional, trupi gjykues konstaton se subjekti, për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, ka gjykuar 662 çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtare dhe 2 çështje tregtare, gjithsej 664 çështje gjyqësore. Ngarkesa e saj sasiore, shprehet KLGJ në raport, ka qenë dukshëm mbi standardin minimal. *(Sipas pikës 3, shkronja “e” të Aneksit nr. 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i shkallës së parë, që është organizuar në dhomë civile, seksioni i përgjithshëm, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 120 gjykime çështjesh civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje me palë kundërshtare, pra për 3 vjet jo më pak se 360 çështje.)*

25.2. Në përfundim të sa më sipër, duke marrë në konsideratë indikatorët të tillë si: (i) tejkalimi i gjykimit tej afatit të arsyeshëm, i cili ka ardhur për shkak të kërkesave procedurale të palëve dhe jo për shkak të mungesave të subjektit; (ii) referuar të dhënave statistikore të përshkruara në raportin profesional, hartuar nga KLGJ-ja, rezulton se ngarkesa e punës për subjektin, për periudhën e rivlerësimit ka qenë dukshëm mbi standardin minimal, e cila ka diktuar në caktimin e seancave në distanca kohore të konsiderueshme nga njëra tjetra, trupi gjykues vlerëson se këto tejkalime çmohen të pamjaftueshme për t’u trajtuar në vlerësimin tërësor të çështjes dhe jopërcaktuese për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

¹³ Subjekti i rivlerësimit, ka shqyrtuar çështjen me objekt “Detyrimin e palës së paditur të lirojë e të dorëzojë sendin truall në Mjull-Bathore... Shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga kabina elektrike pa leje [...]. Për këtë çështje, çështja gjyqësore ka zgjatuar 1 vit e 6 muaj, jashtë afatit 6-mujor, të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit nr. 1 të Sistemit të Vlerësimit.

¹⁴ Denoncuesi ka kërkuar konstatimin gjyqësisht të zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi pa shkaqe të justifikuar dhe në mënyrë të menjëhershme referuar dispozitave të Kodit të Punës. Kohëzgjatja e këtij procesi, ka qenë rreth 2 vite e gjysmë, jashtë afatit 6-mujor, të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit nr. 1 të Sistemit të Vlerësimit.

¹⁵ Denoncuesi ka kërkuar konstatimin gjyqësisht të zgjidhjes së kontratës së huapërdorjes, kthim sendi. Komisioni ka konstatuar se në zhvillimin e këtij procesi gjyqësor nga subjekti i rivlerësimit, 17 muaj mbeten të pajustificuar, jashtë afatit 6-mujor, të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit nr. 1 të Sistemit të Vlerësimit.

¹⁶ Denoncuesi ka kërkuar lëshimin e urdhër ekzekutimit për një deklaratë noteriale. Komisioni, ka konstatuar se kërkesa për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit është depozituar në gjykatë më datë 2.2.2021 dhe subjekti i rivlerësimit është shprehur me vendim më datë 30.03.2021 (më shumë se një muaj më pas), të përcaktuar nga neni 511, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Civile.

¹⁷ Ankesat e denoncuesit janë trajtuar dhe nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”), i cili, me vendimin nr. {***}, datë 16.06.2022, ka vendosur arkivimin e tyre. Në vendimin e ILD-së është konstatuar se: [...] Nga të dhënat e verifikimit të ankesës, rezulton se gjykimi i çështjes civile me nr. {***} dhe nr. {***} Akti, datë 01.07.2019... ka zgjatuar gjithsej 2 vite e 27 ditë në periudhën 02.07.2019 -29.07.2021. Ky afat është normalisht jashtë afatit standard minimal prej 6 muaj, të parashikuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të KLD-së, Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve, Aneksi nr. 1, pika 5, shkronja “e” dhe jashtë afatit të arsyeshëm 2-vjeçar, të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Civile. Shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore, përgjithësisht rezultojnë të jenë për shkaqe procedurale, si për caktimin e ekspertëve përgatitjen dhe paraqitjen e aktit të ekspertimit, njoftimin e palës së paditur, thirrjen dhe paraqitjen e dëshmitarëve. [...]

¹⁸ Denoncuesi ka paraqitur ankim para Komisionit për shumë subjekte rivlerësimi, ndër to edhe për gjyqtaren Blerina Muço në lidhje procesin gjyqësor 8-vjeçar, me objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë. Komisioni ka vlerësuar se në gjithë ecurinë procedurale të gjykimit të kësaj çështje, shkelja kryesore e kryer nga subjekti i rivlerësimit është në momentin e pezullimit, kur kjo çështje është mbajtur nga subjekti 4 muaj dhe më pas është nxjerrë vendimi për pezullim.

C/2 Lidhur me konstatimin mbi mosrespektimin e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 06.12.2013.

26. Komisioni, ka arritur në përfundimin se në vendimin për (i) çështjen nr. {***}, datë 30.04.2015, që i përket dosjes së listuar nr. {***}, nga 5 dosjet e shortuara, subjekti i rivlerësimit nuk i është referuar dhe nuk ka përmendur vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 06.12.2013, duke ndjekur një çështje administrative pa përcaktuar saktë kompetencën lëndore. Të njëjtën problematikë Komisioni e ka konstatuar dhe (ii) në shqyrtimin e denoncimit nr. {***} prot., datë 11.02.2019, të shtetasit V. B., duke vlerësuar se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës.
27. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, duke i qëndruar prapësimeve të paraqitura gjatë hetimit administrativ, parashtron se pretendimet e saj nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, i cili në të dy rastet në konkluzionin e tij, ka reflektuar vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, e cila nuk duhet vlerësuar si shkelje, sepse është normale që gjatë gjykimit të bëhet vlerësimi i rrethanave të çështjes në një këndvështrim të caktuar, të cilin gjykata më e lartë e ka ndryshuar.
28. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të administruara në fashikuj dhe pretendimeve të subjektit në ankim, konstaton dhe vlerëson si vijon:
- 28.1. (i) *Dosja nr. {***}*. Çështja civile nr. {***} regj. themeltar, datë regjistrimi 19.12.2014. Shtetasja E. T. ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesë padinë me objekt *“Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së punës, datë 03.01.2014 dhe detyrimin për dëmshpërblim nga ndërprerja e marrëdhënies së punës [...]”*, e paditur Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Financuara nga Banka Islamike për Zhvillim, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. {***}, datë 30.04.2015, ka vendosur pranimin e padisë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga pala e paditur. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 16.02.2016, ka vendosur moskompetencën për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshje dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
- 28.2. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. {***}, datë 13.07.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se: *“Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk ka qenë kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e çështjes, pasi ligji ngarkon për këtë një gjykatë të veçantë, gjykatën administrative”*.
- 28.3. Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në rezultatet e hetimit administrativ, pasi bazuar në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, duket se subjekti ka gjykuar një çështje gjyqësore që nuk e kishte në kompetencën lëndore të saj.
- 28.4. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e rezultateve të hetimit, ka sqaruar se nga të dhënat e sistemit elektronik të gjykatës, rezulton që kjo çështje është regjistruar në datën 19.12.2014, kohë në të cilën ka qenë në fuqi ligji nr. 49/2012, i cili në nenin 7 përcaktonte kompetencën lëndore të gjykatave administrative, ndër të tjera, edhe: *“ç) Mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike”*. Në interpretim të kësaj dispozite dhe vendimit nr. 3, datë 06.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në çështjen konkrete është vlerësuar se gjykata civile ka qenë kompetente nga pikëpamja lëndore, sepse marrëdhënia e punës në shqyrtim rregullohej nga Kodi i Punës; pala punëdhënëse nuk ishte organ i administratës publike, për shkak të natyrës së veprimtarisë së saj dhe varësisë nga Banka Islamike për Zhvillim. Marrëdhënia e punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës, rregullohej në bazë të dispozitave të

Kodit të Punës, dhe në asnjë rast as nga palët dhe as nga subjekti, nuk është vlerësuar se konflikti përbënte mosmarrëveshje administrative, sikurse konkludon Gjykata e Apelit në vendimin e saj. Subjekti thekson se, sigurisht, është në diskrecionin e gjykatave më të larta të vendosin për kompetencën lëndore apo themelin e çështjes, por nga ana e saj, edhe për shkak se ndarja e kompetencës lëndore ishte ende e paqartë, çështja është gjykuar si konflikt i lindur nga marrëdhëniet e punës që rregulloheshin nga Kodi i Punës midis palëve, të cilat nuk janë organe të administratës publike.

28.5. (ii) *Denoncimin i shtetasit V. B.* Denoncuesi, ish-punonjës i Shërbimit Informativ Shtetëror, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në datë 04.04.2017, duke kërkuar pavlefshmërinë e urdhrit, nëpërmjet të cilit është përjashtuar nga shërbimi. Me vendimin nr. {***}, datë 07.09.2017, të kësaj gjykate, është vendosur shpallja e moskompetencës lëndore dhe dërgimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Çështja e tij, është trajtuar fillimisht nga gjyqtar N. Rr., e pas pranimit të kërkesës së tij për përjashtim, çështja i ka kaluar për gjykim subjektit të rivlerësimit.

28.6. Komisioni administroi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kopje të vendimit nr. {***} akti, datë 11.12.2018, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe kopje nga numërori i vendimeve të kësaj gjykate. Vendimi, objekt denoncimi, me palë paditëse shtetasin V. B., me palë të paditur Shërbimin Informativ të Shtetit (*ShIsh*) ka për objekt: *Anulimin e Urdhrit për përjashtimin nga shërbimi si dhe detyrimet e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin sipas Kodit të Punës.* Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Nga shënimi në vendim, evidentohet se, kjo gjykatë ka vendosur prishjen e vendimit nr. {***}, datë 11.12.2018, dhënë nga subjekti, si dhe dërgimin e çështjes për kompetencë gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

28.7. Komisioni, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi vendimi i subjektit të rivlerësimit është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka evidentuar shkelje në vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

28.8. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, ka shpjeguar se kur çështja është trajtuar nga ana e saj, ka çmuar se kompetenca lëndore ka qenë e përcaktuar më parë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe, në këtë mënyrë, është vijuar me marrjen në shqyrtim të çështjes. Ndërkohë, Gjykata e Apelit Tiranë, si shkallë më e lartë gjykimi dhe brenda të drejtave që i njej ligji procedural civil, në vendimin nr. {***}, datë 20.01.2020, ka përcaktuar në mënyrë përfundimtare, si gjykatë kompetente për shqyrtimin e çështjes, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke e rikthyer edhe një herë për gjykim pranë kësaj Gjykate.

28.9. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të çështjeve, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk i është referuar dhe nuk ka përmendur vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 06.12.2013, duke ndjekur një çështje administrative pa përcaktuar saktë kompetencën lëndore, vlerëson se ky konstatim i Komisionit qëndron vetëm në rastin e dosjes nr. {***} të vitit 2014, ku palë e paditur është Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Financuara nga Banka Islamike për Zhvillim, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, dhe objekt padie konstatimi i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se në rastin konkret, pala e paditur, duket se ka një status të diskutueshëm, sa i përket përcaktimit nëse mosmarrëveshja përfshihet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve shtetërorë në administratën publike apo të punonjësve, marrëdhënia e të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës. Në çdo rrethanë, ky rast i veçuar çmohet i pamjaftueshëm për të ndikuar në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

28.10. Në rastin e çështjes të shtetasit V. B., e vitit 2017, trupi gjykues vëren se paditësi ka pasur një marrëdhënie juridike të punës, e cila *prima facie* duket se nuk rregullohej në mënyrë të plotë nga ligji i posaçëm. Për rrjedhojë, duket se subjekti, në mënyrë të gabuar e ka vlerësuar atë si një marrëdhënie pune që rregullohej nga Kodi i Punës, e cila është kompetencë lëndore e gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm. Trupi gjykues thekson se zbatimi i nenit 7, germa “ç” e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar me ligjin nr. 39/2017, datë 30.03.2017, nuk kishte krijuar ende një praktikë të konsoliduar në sistemin gjyqësor shqiptar sa i përket vlerësimit se cilat ishin marrëdhëniet e punës së nëpunësve shtetërorë që rregullohen me ligj të posaçëm, në kompetencë lëndore të gjykatës administrative. Në konsideratë të kohës së dhënies së këtij vendimi, pothuaj një vit pas këtij ndryshimi ligjor dhe faktit se konfuzioni mbi kompetencën, fillimisht është shkaktuar nga vetë Gjykata Administrative, e cila ka qenë e para që e ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një çështje në kompetencë të saj, trupi gjykues nuk e konsideroi me peshë problematikën e evidentuar për kompetencën lëndore në këtë çështje.

C/3 Lidhur me konstatimet mbi konfliktin e interesit

29. Komisioni, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, ka mbajtur në konsideratë se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për të shmangur gjykimet e saj në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, të cilat në dukje kanë cenuar paanshmërinë e magjistratit, konkretisht në çështjet e gjykuara nga subjekti me palë shoqërinë “{***}” ShPK, me të cilën bashkëshorti i subjektit kishte lidhur kontratën e shitblerjes së apartamentit në vitin 2000, si dhe në çështjet e shortuara me shoqërinë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShA, me të cilat bashkëshorti ka kryer shërbime konsulente.

*C/3.1 Lidhur me konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK*

30. Komisioni, lidhur me çështjet e gjykuara nga subjekti me palë shoqërinë “{***}” ShPK, ka konstatuar se ato janë kryer disa vite më vonë se momenti i përfundimit të transaksionit të blerjes së apartamentit, nuk provohet gjendja e konfliktit faktik të interesit, por, pavarësisht këtij konstatimi, këtë situatë e ka çmuar në kontekstin e cenimit të integritetit, si pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale e, për rrjedhojë, e ka mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
31. Subjekti i rivlerësimit, në ankim pretendon se në konkluzionin e Komisioni ka një mungesë koherence, pasi edhe pse konstaton se nuk ka konflikt interesi, vlerëson se ka cenim të integritetit. Subjekti kërkon që ky qëndrim i Komisionit të rivlerësohet nga Kolegji në përputhje me rezultatet e dala nga hetimi administrativ, të cilat provojnë se procedura e blerjes së apartamentit është plotësisht ligjore, çmimi është real dhe nuk ekziston asnjë konflikt interesi në gjykimin e çështjeve me palë shitësin, sikurse është vlerësuar në mendimin e pakicës.
32. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, konstaton dhe vlerëson se:

32.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe 138 m², me nr. pasurie {***}, i ndodhur në {***}, Tiranë, blerë në datë 24.06.2000, kundrejt çmimit 5,000,000 lekë, me financim 100% nga kredia e lëvruar nga banka e kursimeve/Raiffeisen Bank, në shumën 5.000.000 lekë*”.

32.2. Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri dhe si burim kredinë e marrë nga Banka e Kursimeve. Kjo

pasuri është konfirmuar dhe nga praktika e përcjellë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë¹⁹.

32.3. Gjatë hetimit administrativ subjekti, ka vënë në dispozicion të Komisionit, (i) praktikën e ndjekur nga bashkëshorti për përfitim të kredisë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politik dhe të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore”; (ii) urdhër xhirimin me nr. Serie {***}, datë 12.10.2000, lëshuar nga bashkëshorti, nëpërmjet të cilit kreditorin shoqërinë “{***}” ShPK, me shumën 5.000.000 lekë, nga ish-Banka e Kursimeve, si dhe (iii) të dhëna nga sistemi elektronik i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me çështjet e trajtuara nga subjekti i rivlerësimit me shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK dhe/ose ortakun e saj, nga ku rezultoi se ka trajtuar çështjet, si në vijim:

1. Padiës A. D. (ortak në shoqëri) dhe i paditur, shoqëria “{***}” ShPK, regjistruar në datë 20.09.2007 (7 vite më pas), dhe përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 11.07.2011. Subjekti ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë dhe rrëzimin për pjesën tjetër të saj. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 08.10.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe me vendimin nr. {***}, datë 10.03.2016 të Gjykatës së Lartë.

2. Padiës E. I. dhe i paditur, shoqëria “{***}” ShPK, regjistruar në datë 07.09.2012 (12 vite më pas), dhe përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 29.04.2013. Subjekti ka vendosur pranimin e padisë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 23.10.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 04.12.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit.

3. Padiës shoqëria “{***}” ShPK dhe i paditur, shoqëria përmbarimore “{***}” ShPK, regjistruar në datë 11.10.2018 (18 vite më pas), dhe përfunduar me vendimin nr. {***}, datë 11.03.2019. Subjekti ka vendosur rrëzimin e padisë. Me vendimin nr. {***}, datë 10.10.2019, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien të fuqi të vendimit. Aktualisht kjo çështje ndodhet për shqyrtim me rekurs në Gjykatën e Lartë.

32.4. Komisioni ka hetuar lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit në vlerën 5.000.000 lekë, në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Tiranës. Nisur nga fakti se në vitin 2000, mungojnë çmimet e referencës, duke iu referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 31.05.2001, Komisionit i ka rezultuar se subjekti duket se e ka blerë këtë pasuri, më pak se vlera e tregut të lirë prej 8.502.206 lekë²⁰ (151 m² x 56.306 lekë/m²).

32.5. Për sa ka rezultuar nga hetimi administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me procedurat e ndjekura për blerjen dhe regjistrimin e pasurisë, çmimin e blerjes, si dhe faktit se subjekti nuk ka bërë kërkesë për heqje dorë dhe ka shqyrtuar çështje gjyqësore me palën shitëse të apartamentit, shoqërinë “{***}” ShPK, duke mos shmangur kështu konfliktin e interesit në dukje, shoqëruar me dokumentacionin mbi vendimmarrjet e saj me shoqërinë ndërtimore.

32.6. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e rezultateve të hetimit, ka dhënë shpjegime mbi kronologjinë e përfitim të kredisë, çmimin e blerjes së pasurisë si dhe momentin e regjistrimit të pasurisë, duke paraqitur si provë edhe kontrata të tjera të ngjashme të përafërta në çmim me apartamentin e blerë nga ana e saj, në të njëjtën godinë dhe periudhë, gjë për të cilën Komisioni ka

¹⁹ Me shkresën nr. {***}, datë 19.02.2018, të ZVRPP-së (Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), Tiranë, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Sipas këtij udhëzimi, Komisionit i ka rezultuar se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës është në vlerën 56.306 lekë për m². Sipërfaqja e ndërtimit të apartamentit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është në total 151 m².

vlerësuar se ka lehtësuar pozitën e saj, në raport me barrën e provës të lënë për këtë çështje. Po ashtu, subjekti ka depozituar të dhëna të nxjerra nga sistemi elektronik i gjykatës, mbi të tre gjykimet, të cilat janë kryer shumë më vonë në kohë nga momenti i përfundimit të transaksionit të blerjes së apartamentit, duke shpjeguar se në asnjë prej këtyre çështjeve, nuk ka ekzistuar shkak ligjor që ta vendoste atë në pozitën e konfliktit të interesit në momentin e gjykimin.

32.7. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me konstatimin e Komisionit, mbi gjendjen e konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, me të cilën bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontratën për blerjen e “*Pasurisë apartament me sipërfaqe 151 m²*”, në vitin 2000, duke mbajtur në konsideratë faktet që: (i) parashikimet e Kodit Civil lidhur me lirinë kontraktore të palëve janë të përfshira në transaksionin e shitblerjes. (ii) Subjekti, me anë të kontratave të ngjashme sqaroi pozitën e saj në raport me çmimin e përcaktuar në këtë kontratë, si dhe nga hetimi nuk rezultojnë gjetje që të provojnë se subjekti ka paguar efektivisht një vlerë të ndryshme nga sa deklaruar. (iii) Marrëdhënia e shitblerjes së apartamentit me këtë shoqëri, ka përfunduar në vitin 2000, dhe nga e cila nuk rezultoi të ketë ndonjë vazhdimësi në çfarëdo forme, që të ishte prezente në kohën e përfshirjes së subjektit të rivlerësimit në çështjet e regjistruara *7-12-18 vite më pas*. (iv) Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë rezultuar me pamjaftueshmëri financiare për krijimin e kësaj pasurie. (v) Vendimet e subjektit, në të cilat ka qenë palë kjo shoqëri i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor nga gjykatat më të larta dhe janë lënë në fuqi, arrin në përfundimin që konkluzioni i Komisionit, se kjo situatë duhet mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në kontekstin e cenimit të integritetit, nuk gjendet i arsyetuar dhe i mbështetur nga aktet në dosjen gjyqësore të Komisionit, si dhe është i pabazuar në ligj.

*C/3.2 Lidhur me çështjet e shqyrtuara me shoqërinë “{***}” ShPK*

33. Komisioni nisur nga marrëdhënia e konsulencës që bashkëshorti i subjektit ka pasur me këtë shoqëri, duke konkluduar të dyja palët në shmangie dhe përfitime financiare për mospagim detyrimesh tatimore ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes gjyqësore, ku palë ndërgjyqëse ka qenë shoqëria “{***}” ShPK, duke u vetëpërgjashtuar paraprakisht nga procesi konkret vendimmarrës, e duke mos marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes.
34. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, pretendon se konkluzioni i Komisionit, ngrihet mbi premisën se *bashkëshorti i subjektit ka pasur marrëdhënie favorizuese me këtë shoqëri*, premisë e cila, sikurse ka mbajtur qëndrim dhe në vlerësimin e kriterit të pasurisë, nuk ka ekzistuar e për pasojë, çdo përgjigje për konkluzionet e Komisionit lidhur me konfliktin e interesit është i panevojshëm.
35. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, konstaton se subjekti ka shqyrtuar çështje gjyqësore me palë shoqërinë “{***}” ShPK/“{***}” ShPK, dhe ka marrë këto vendime:

(i) Vendimi nr. {***}, datë 24.12.2013, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me palë ndërgjyqëse: Paditës, {***}, i paditur, {***},²¹ Person i Tretë shoqëria “{***}” ShPK. *Subjekti ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në shqyrtimin e çështjes civile me nr. {***} Akti. Dërgimin e dosjes civile me nr. {***} Akti për kompetencë lëndore Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendim i cili ka marrë formë të prerë me datë 19.01.2014, pasi nuk u ankimua.*

²¹ Objekti: Anulimi i pjesshëm i vendimit nr. {***}, datë 25.06.2013, i Drejtorisë së Apelitit Tatimor.

(ii) Vendimi nr. {***}, datë 23.12.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me palë ndërgjyqëse: Padiës D. Ll.²², i paditur shoqëria “{***}” ShPK. *Subjekti ka vendosur rrëzimin e padisë, vendim i cili është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e datës 17.10.2017.*

(iii) Vendimi nr. {***}, datë 23.10.2017, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me palë ndërgjyqëse: Padiës, D. Ll., i paditur, shoqëria “{***}” ShPK,²³ i cili aktualisht është me statusin ankimuar. *Subjekti ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.*

(iv) Vendimi nr. {***}, datë 14.11.2017, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me palë ndërgjyqëse: Padiës shoqëria “{***}” ShPK dhe të paditur “{***}” ShPK²⁴. *Subjekti i rivlerësimit ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore të Gjykatës Tiranë dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës Elbasan, vendim ky i lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Lartë, me vendimin civil të datës 19.12.2017.*

35.1. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e rezultateve të hetimit, ndër të tjera ka sqaruar se në asnjë rast nuk ka pasur konflikt interesi me asnjë prej ortakëve apo përfaqësuesve të shoqërisë, sikurse asnjë interes që mund ta vinte në kushte serioze njëanshmërie, për të paraqitur kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, të cilat i ka vlerësuar rigorizisht sipas parashikimeve të nenit 72 të Kodit Procedurës Civile. Marrëdhënia juridike e konsulencës me këtë shoqëri, ka përfunduar në vitin 2008 dhe efektet financiare të detyrimeve të papaguara në vitin 2010, pra shumë kohë përpara regjistrimit të çështjeve në gjykatë. Subjekti i rivlerësimit, ka referuar dhe jurisprudencën e Kolegjit, e cila ka arsyetuar situata të ngjashme, konkretisht vendimin nr. 16 (JR), datë 13.07.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit H. D.²⁵.

35.2. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me konstatimet e Komisionit, mbi gjendjen e konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, nga aktet në dosje, konstaton se nga katër çështjet e evidentuara të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit me këtë shoqëri, më e hershmja, ajo e vitit 2013, në të cilin subjekti ka shpallur moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes civile për kompetencë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se është trajtuar 3 vite pasi ka përfunduar marrëdhënia e interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, për shkak të shlyerjes së pagesave të prapambetura të kaluara bashkëshortit të subjektit, në vitin 2010. Ndërsa 3 rastet e tjera, që datojnë respektivisht në datat 23.12.2016; 23.10.2017 dhe 14.11.2017, janë trajtuar rreth 6 (gjashtë), 7 (shtatë) vite më pas. Trupi gjykues, në konsideratë dhe sa arsyetuar mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga shoqëria “{***}” ShPK, çmon se konkluzioni i Komisionit, mbi gjendjen e konfliktit të interesit, gjendet i pabazuar.

*C/3.3 Lidhur me çështjet e shortuara me shoqërinë “{***}” ShA*

²² Objekti: “Zgjidhja e menjëhershme dhe e pajustificuar e kontratës së punës, ndërmjet palëve ndërgjyqëse; detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin me pagën e 12 muajve [...]”.

²³ Objekti: Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin për dëmin pasuror dhe dëmin jopasuror (dëmin mbi shëndetin/dëmin biologjik, dëmin moral dhe ekzistencial), të shkaktuar nga aksidenti në punë, në shumën prej 2.000.000 lekë. Detyrimin e të paditurit të paguajë shpenzimet gjyqësore.

²⁴ Objekti: “Lirimi dhe dorëzimi i sheshit të {***}, duke larguar Impiantin e Përpunimit të Skorieve dhe largimin e mbetjeve agregate nga ambientet e uzinës dhe kthimin e saj në gjendjen fillestare. Përmbushjen e detyrimeve kontraktore në shumën 76.817,54 USD, si pasojë e mospagimit të faturave tatimore të lëshuara nga pala paditëse; Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zënia e sipërfaqes së {***} pas përfundimit të kontratës, në formën e qirasë mujore për periudhën qershor 2015, deri në datën e ngritjes së padisë, në vlerën totale 33.600.000 lekë; Shpërblimin e dëmit në formë e kamatë vonesave mbi detyrimin kontraktor të pashlyer, në vlerën 820 USD; Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke vendosur sekuestro preventive mbi Impiantin e Përpunimit të Skorieve që zotëron i padituri, për mos-tjetërsimin e këtij asemi të shoqërisë.

²⁵ Në këtë rast, ndër të tjera, Kolegji ka arsyetuar se: “Kolegji konsideron se zgjidhja e çështjes e pretenduar nga subjekti duhet parë në raport me dispozitat e ligjit nr. 9367/2005, të cilat përcaktojnë institutin e interesit pasuror dhe gjendjen e konfliktit të interesit, si edhe kushtet dhe procedurat si një zyrtar duhet ta deklarojë dhe shmangë atë... në këtë kontekst Kolegji konstaton se norma e zbatueshme për rastin konkret është neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon rastet kur një gjyqtar është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje për të shmangur konfliktin e interesit”.

36. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht pretendimeve se nuk ka kryer asnjë veprim procedural për 2 (dy) çështje të shortuara me këtë shoqëri, konstaton vonesa të theksuara në fillimin e gjykimit të çështjeve dhe mbajtjen e tyre për një kohë të gjatë pa kryer veprime, me qëllim favorizimin e palës ndërgjyqëse, shoqërinë “{***}” ShA, duke u ndodhur kështu në situatën e konfliktit të interesit, duke vlerësuar se analiza e bërë për situatën e konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, qëndron dhe për këtë rast.
37. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, sikurse dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, pretendon se nuk ka kryer asnjë veprim procedural në dy çështjet e evidentuara me këtë shoqëri, përveç kërkesës për heqje dorë nga gjykimi. Nëse Komisioni do të kishte treguar paksa kujdes në leximin e kërkesave për heqje dorë nga gjykimi, nuk do të kishte arritur në konkluzionin për *vonesa të theksuara në fillimin e gjykimit të këtyre çështjeve*. Për subjektin e rivlerësimit, paralelizmi që bën Komisioni me konfliktin e interesit në rastin e shoqërisë “{***}” ShPK, është i pavend, sepse nuk ka asnjë lidhje midis dy situatave.
38. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, konstaton se subjekti është shortuar për këto çështje:
- (i) Çështja civile nr. {***} akti, datë regjistrimi 21.08.2020 me palë: Padiçese, {***}, të paditur, shoqëria “{***}” ShA, palë e tretë, “{***}”, me objekt: Detyrimin e palës së paditur për lirimin e objektit “Ambiente në {***}”, Tiranë. Kjo çështje, në datën 20.10.2022, i ka kaluar me short gjyqtares Blerina Muço.
- (ii) Çështja civile nr. {***} akti, datë regjistrimi 01.10.2021 me palë: padiçese “{***}” ShA dhe të paditur {***}, palë e tretë “{***}”, me objekt: Zgjidhjen e kontratës së qirasë, të datës 03.05.2013, pagimin e dëmshpërblimeve etj. Kjo çështje në datë 26.05.2023 i ka kaluar me short gjyqtares Blerina Muço.
- 38.1. Në prapësimet e paraqitura gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka sjellë si provë dy vendimet e miratuara nga Kryetari i Gjykatës, për heqjen dorë të subjektit nga trajtimi i tyre, për shkak se aksionari kryesor i palës së paditur është shoqëria “{***}” ShPK, me ortak të vetëm I. H., dhe bashkëshorti i saj është i punësuar si administrator pranë Universitetit “{***}”, ku aksionar është ky shtetas. Kërkesat e subjektit për heqjen dorë mbajnë datën 29.06.2023.
- 38.2. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me konstatimet e Komisionit, mbi gjendjen e konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShA, vëren se në çështjet me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShA, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim procedural gjyqësor nga momenti i regjistrimit të këtyre çështjeve në gjykatë. Në kushtet kur personi i lidhur, bashkëshorti, kishte marrëdhënie interesi me këtë shoqëri, vonesat e subjektit të rivlerësimit në paraqitjen e kërkesave për heqjen dorë nga shqyrtimi i këtyre çështjeve, përkatësisht 1 (një) muaj dhe 8 (tetë) muaj pas regjistrimit të tyre, në vlerësim të trupit gjykues, mbeten të pajustificuara. Megjithatë kjo problematikë, e vetme, u konsiderua pa peshë specifike apo ndikim ligjor në këtë vendimmarrje.
- C/4 Lidhur me përdorimin e mbiemrave të ndryshëm*
39. Komisioni, në vlerësimin e kriterit profesional në tërësi, ka mbajtur në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit ka përdorur mbiemra të ndryshëm nga mbiemri zyrtar në praktika, akte të ndryshme dhe në të gjitha çështjet e gjykuara në gjykatë, duke vlerësuar se kjo sjellje e subjektit cenon etikën, rolin dhe figurën e një magjistrati.

40. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e paraqitur, kërkon nga Kolegji që të rishikojë qëndrimin e Komisionit, mbi bazën e argumenteve që ka parashtruar në prapësimet e rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore në Komision. Subjekti i rivlerësimit, kërkon mirëkuptimin, për të vlerësuar këtë situatë në mënyrë objektive, në konsideratë dhe të parregullsive që kanë ekzistuar ndër vite në regjistrat e gjendjes civile.

41. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, konstaton se Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka rezultuar se në të gjitha vendimet gjyqësore subjekti ka përdorur mbiemrin Muça, të ndryshëm nga mbiemri zyrtar Muço.

41.1. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e rezultateve të hetimit, ka shpjeguar se situata e krijuar me përdorimin e disa mbiemrave është absurde, por vjen si rezultat i situatave faktike reale, dhe jo pasojë e ndryshimeve formale. Në aktet e gjendjes civile nuk ka asnjë veprim për ndryshimin e mbiemrit, pra formalisht, mbiemri sipas gjendjes civile i bashkëshortit është Muço, sikurse provohet me letërnjoftimin e datës 07.07.1989, paraqitur bashkëlidhur. Çdo dokument me origjinë zyrtare si pasaporta, kartë identiteti, certifikata etj., kanë këtë mbiemër. Ndërkohë, subjekti ka shpjeguar se që nga lindja, prej familjarëve është përdorur mbiemri Muçaj, i cili në fakt është mbiemri zyrtar i të gjithë familjarëve të tjerë të bashkëshortit, përfshirë xhaxhallarë, etj. Kjo situatë nënkupton pasaktësi në regjistrime në gjendjen civile, ku vetëm njëri prej vëllezërve, babai i bashkëshortit dhe trangu i tij familjar, janë me mbiemër Muço. Në funksion të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur kopje të diplomës së universitetit të bashkëshortit, ku mbiemri rezulton Muçaj, edhe pse letërnjoftimi është me mbiemrin Muço.

41.2. Trupi gjykues i Kolegjit, në vlerësim të situatës faktike të konstatuar nga Komisioni dhe të pranuar hapur edhe nga subjekti, duke mbajtur në konsideratë problematikat që ka mbartur regjistrimi i gjeneraliteteve në regjistrat e gjendjes civile në vendin tonë, parë në një kontekst logjik dhe të arsyeshëm në funksion të këtij procesi, e konsideron pa peshë këtë gabim material të subjektit të rivlerësimit dhe të pamjaftueshëm për ta kualifikuar atë si shkak për t'u trajtuar në vlerësim tërësor të çështjes dhe përcaktues për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

42. Sa më sipër, trupi gjykues, pasi analizoi të gjitha gjetjet e paraqitura në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, për sa më sipër arsyetuar, arriti në konkluzionin se, qëndrimi i Komisionit në lidhje me kontrollin e kriterit të vlerësimit të pasurisë dhe kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale apo gjetjet, të cilat u mbajtën në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, nuk janë rezultat i një vlerësimi të drejtë dhe në harmoni me aktet e administruara dhe dispozitat ligjore në fuqi. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se zbatimi nga Komisioni i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton shkarkimin nga detyra për subjektin e rivlerësimit, si rezultat i cenimit të besimit të publikut është i gabuar.

43. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur, në mënyrë kumulative, nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit dhe nuk ka cenuar besimin e publikut, duke u ndodhur në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 711, datë 01.11.2023, që ka shkarkuar nga detyra subjektin e rivlerësimit, është i pambështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 711, datë 01.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Blerina Muço.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 13.10.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtarja Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, kam votuar kundër vendimit nr. 71, datë 13.10.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur *ndryshimi i vendimit nr. 711, datë 01.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit Blerina Muço*, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për t'u konfirmuar në detyrë, për arsyet si më poshtë:

A. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

*A/1 Lidhur me të ardhurat në shumën 73 000 euro të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nga shërbimet e konsulencës me shoqërinë “{***}” ShPK*

1. Komisioni ka vlerësuar se: *Të ardhurat e deklaruara në deklaratën vetting, në shumën 73.000 euro, me burim marrëveshjen e bashkëpunimit me shoqërinë “{***}” ShPK, për të cilat subjekti nuk ka arritur të provojë pagimin e detyrimeve tatimore, nuk do të konsiderohen si të ardhura, të cilat plotësojnë kriteret e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe, si të tilla, nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit si të ardhura të ligjshme.*
2. Konkluzioni i shumicës së trupit gjykues, *për përfshirjen e tyre në mesin e të ardhurave të ligjshme*, nuk është rrjedhojë e një arsyeimi logjik e bindës, i pabazuar në fakte dhe në prova, si dhe nuk qëndron në raport me standardin ligjor të ligjshmërisë së të ardhurave, të përcaktuara sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit.
3. Shumica e trupit gjykues ka arritur në këtë përfundim, duke pranuar: (i) *“Marrëveshje bashkëpunimi”, jonoteriale, të datës 15.08.2005, dhe “Marrëveshje për shlyerje detyrimesh në të holla”, datë 14.05.2009*, lidhur mes bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK; (ii) kalimin e kësaj shume nëpërmjet sistemit bankar; (iii) zgjidhjes që Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (në vijim “Gjykata”), me vendimin nr. {***}, datë 01.03.2024, i ka dhënë padisë së personit të lidhur me subjektin, sa i përket përgjegjësisë ligjore kundrejt pagesës së detyrimeve tatimore, si dhe (iv) në vlerësimin e shumicës, nuk provohet se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në keqbesim në lidhje me mospagimin e detyrimeve tatimore.
4. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, çmoj se këto të ardhura nuk plotësojnë kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ku shprehimisht thuhet se: *subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.* Për këtë arsye kam vlerësuar se këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare, në mesin e të ardhurave të ligjshme.

4.1. Së pari, shumica e trupit gjykues, nuk ka vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme detyrimin ligjor të subjektit të rivlerësimit për të bërë deklarime të sakta dhe të plota në deklaratën e pasurisë *vetting*, konform ligjit, si dhe për t'i mbështetur këto deklarime me dokumentacion ligjor. Ky detyrim, i përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, përbën një element thelbësor në procesin e rivlerësimit kalimtar dhe mospërmbyshja e tij cenon besueshmërinë e deklarimeve të subjektit dhe të personit të lidhur me të, në raport me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, për efekt të këtij procesi.

Subjekti i rivlerësimit, në dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk ka paraqitur marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 15.08.2005, lidhur nga bashkëshorti me shoqërinë “{***}” ShPK / “{***}” ShPK, të cilën e ka paraqitur vetëm në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, kur Komisioni kishte konstatuar mungesën e deklaramit të këtyre të ardhurave në organet tatimore dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore lidhur me to. Vetëm në këtë moment, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision këtë marrëveshje, duke pretenduar se sipas saj, detyrimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore i takonte shoqërisë “{***}” ShPK. Kohëzgjatja trevjeçare sipas përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje të vitit 2005, e vlefshme deri në vitin 2008, nuk përkon me vitet që personi i lidhur me subjektin ka përfituar të ardhura nga kjo shoqëri, deri në vitin 2010.

Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, vetëm pas kalimit të barrës së provës dhe për nevoja të justifikimit të mospërputhjeve ndërmjet kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes së vitit 2005 dhe kohës së kryerjes së pagesave deri në vitin 2010, paraqiti një marrëveshje të re, atë të datës 14.05.2009, e cila nuk ishte bashkëlidhur më parë me aktet e depozituara në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në përgjigje të pyetësorit nr. 3. Për më tepër, marrëveshja për shlyerje detyrimesh në të holla, e datës 14.05.2009, me shoqërinë “{***}” ShPK / “{***}” ShPK, është nënshkruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me cilësinë e avokatit. Bazuar në ekstraktin e regjistrit tregtar rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar, më datë 03.12.2009, si person fizik për ushtrimin e veprimtarisë si avokat, që e bën të dyshimtë ekzistencën e marrëveshjes.

4.2. *Së dyti*, ndryshe nga sa konsideron shumica e trupit gjykues, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerësoj se kalimi i kësaj shume nëpërmjet sistemit bankar të personit të lidhur, nuk është i mjaftueshëm për ta legjitimuar atë si të ardhur të ligjshme për efekt të këtij procesi, për sa kohë për këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet tatimore.

Për më tepër, subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në Kolegji, nuk arriti të provojë ekzistencën e kësaj marrëveshjeje me dokumentacion të ligjshëm, si dhe realizimin e shërbimeve të pretenduara, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për realizimin e të ardhurave mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara. Në këto kushte, kalimi i kësaj shume përmes sistemit bankar nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për ekzistencën reale të marrëdhënieve të pretenduara apo për ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara.

4.3. *Së treti*, shumica e trupit gjykues nuk i ka vlerësuar drejt të gjitha rrethanat, që provonin keqbesimin e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, në drejtim të shmangies së shlyerjes së këtyre detyrimeve tatimore, me vullnet të tyre të plotë.

Sa i përket qëndrimit të shumicës, se detyrimin për pagimin e tatimit e ka pasur shoqëria, vlerësoj se, ky qëndrim synon të ligjërojë të gjitha të ardhurat e pretenduara të përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga kjo shoqëri, për një shërbim, i cili në fakt nuk provohet se ka ndodhur. Për më tepër, nga hetimi administrativ rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka zgjedhur të kryejë shërbimet e konsulencës pa u regjistruar në organet tatimore, për të ushtruar aktivitetin si person fizik. Mosregjistrimi si person fizik duket se është bërë me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore, për këto të ardhura të përfituara nga marrëveshja me shoqërinë “{***}” ShPK dhe, mesa duket, u ka shërbyer të dyja palëve kontraktore, element tjetër që vë në dyshim ekzistencën e kësaj marrëveshjeje.

Kjo situatë, si dhe problematikat e konstatuara mbi mungesën e shlyerjes së detyrimeve tatimore dhe në shoqëritë e tjera ku personi i lidhur me subjektin ka qenë i punësuar, përforcojnë bindjen se personi i lidhur dhe subjekti kanë pasur dijeni të plotë për mungesën e pagimit të detyrimit tatimor për këto

të ardhura të përfituara dhe janë pajtuar me këtë situatë, për një periudhë kohore të gjatë dhe të përsëritur të ushtrimit të aktivitetit të bashkëshortit të saj.

Në rastin konkret, rezulton e përsëritur një mënyrë veprimi e përfitimit të të ardhurave jashtë sistemit fiskal, çka në vlerësimin tim, përjashton mungesën e padijenisë së subjektit të rivlerësimit lidhur me mospagimin e tatimit mbi këto të ardhura. Ky konstatim përforcohet edhe nga fakti se bashkëshorti i subjektit, në disa prej këtyre shoqërive, ka ushtruar detyrën e administratorit dhe, për shkak të pozicionit të punës, ka qenë plotësisht në kushtet që të ishte në dijeni për mospagimin e tatimit për të ardhurat e përfituara.

4.4. *Së katërta*, vlerësoj se padia e ngritur nga bashkëshorti i subjektit, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur shoqëria ‘{***}’ ShPK, të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale për periudhën 2005 – 2010”*, depozituar më datë 06.10.2023, pranë kësaj gjykate, daton pas kalimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni në datën 26.09.2023²⁶, është veprim i kryer nga subjekti për efekt të procesit të rivlerësimit dhe, si i tillë, duhej të merrej me rezervë në këtë proces.

Shumica e trupit gjykues, duke iu referuar vendimit nr. {***}, datë 01.03.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, të paraqitur nga subjekti në Kolegj, i ka dhënë atij një vlerësim duke i konsideruar në vijim këto të ardhura si të ligjshme. Ky vendim i vitit 2024, i cili i referohet marrëveshjes së vitit 2005, kufizohet vetëm në trajtimin e përgjegjësisë së shoqërisë “{***}” ShPK, për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

Ky vendim në vlerësimin tim, nuk mund të korrigjojë sjelljen e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, pas një periudhe shumë të gjatë kohore, për efekt të këtij procesi, në drejtim të përfitimit të këtyre të ardhurave të konsiderueshme, në kushtet kur evidentohet dijenia e tyre mbi shmangien e shlyerjes së detyrimeve tatimore. Subjekti i rivlerësimit, si në Komision, ashtu dhe në Kolegj, nuk arriti të provojë padijeninë e saj lidhur me mosshlyerjen e këtyre detyrimeve tatimore, por për mua, si gjyqtare në pakicë, padia e ngritur është një veprim i subjektit për të mbuluar *puzzle-in* e mungesës së burimeve financiare të ligjshme.

Kolegji, në referim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka mbajtur një qëndrim orientues në jurisprudencën e tij²⁷, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të mundësojnë legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, duke çmuar se vlerësimi i tyre do të duhet të bëhet duke konsideruar *sjelljen e subjektit apo të personave të lidhur dhe të personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Në çdo rast, këto të ardhura nuk mund të legjitimohen, nëse subjektet, personat e lidhur apo personat e tjerë të lidhur kanë qenë në kushte keqbesimi, në kufijtë e kryerjes së një vepre penale.*

Unë, si gjyqtare në pakicë, në kuadër të këtij procesi, nga vetë natyra kalimtare e tij, dhe në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor për subjektet e rivlerësimit, e kam vlerësuar gjithmonë marrjen e provave të paraqitura nga subjektet, sipas formave të parashikuara në ligj, në kuadër të nenit 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen. Por, rasti konkret paraqitet ndryshe, pasi subjekti, vetëm në përgjigje të pyetësorëve nga Komisioni, paraqiti një “akt marrëveshjeje” të vitit 2005, e cila nuk përmbushte kriteret ligjore për t’u konsideruar dhe vlerësuar si provë e vlefshme në kuadër të këtij procesi, si dhe

²⁶ Subjekti paraqiti në rrugë zyrtare, pranë Komisionit, më datë 09.10.2023, përgjigjet mbi rezultatet e hetimit.

²⁷ Vendimin nr. 15/2021 (JR), të Kolegjit.

duke mos u deklaruar asnjëherë nga subjekti, si në deklaratat periodike vjetore, as në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kuadër të procesit të rivlerësimit pranë ILDKPI-së.

Nëse subjekti do të kishte paraqitur në këtë fazë procedurale, marrëveshjen e vitit 2005, në formën e duhur ligjore, qëndrimi im do të ishte ndryshe dhe do të mbështesja pranimin e saj si provë, pasi vërteton vullnetin e palëve në kohën e lidhjes së marrëveshjes, që në rastin në fjalë është krejt e ndryshme. Veprimet e ndërmarra nga subjekti gjatë këtij procesi përbëjnë përpjekje të papranueshme, të cilat nuk duhet të legjitimohen në funksion të tij.

Nga verifikimi i përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje konstatohet se shërbimet e parashikuara të konsulencës nuk përputhen me natyrën juridike të një kontrate porosie, si pretendon subjekti, por paraqesin elemente tipike të shërbimeve juridike profesionale, duke e bërë të pabazuar përsëri ekzistencën e kësaj marrëveshjeje në vitin 2005, si dhe kualifikimin e dhënë nga subjekti si kontratë porosie, sipas nenit 913 të Kodit Civil.

Në praktikën e deritanishme, shumica e trupit gjykues ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar, duke vlerësuar me rezervë dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazat e avancuara të procesit të rivlerësimit, ndërsa në këtë rast ka vepruar ndryshe, duke i pranuar ato në cilësinë e provës dhe duke reflektuar në analizë shumë prej 73.000 euro, si të ardhura të ligjshme, me pasojë përmirësimin ndjeshëm të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit.

Për sa arsyetuar më sipër, vlerësoj se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga shërbimet e konsulencës me shoqërinë “{***}” ShPK, në shumën 73 000 euro, nuk e kalojnë testin e ligjshmërisë dhe nuk duhet të përfshihen në analizën financiare si burime të ligjshme. Përkundrazi, nga analiza në tërësi e rrethanave, rezulton se ato janë përfituar në një kontekst mungese transparence, në mospërputhje të deklarimeve dhe mosrespektim të detyrimeve tatimore të detyrueshme për t’u zbatuar.

A/2. Lidhur me deklarinimin e gjendjes cash

5. Komisioni vlerësoi se: [...] *Subjekti ka bërë deklarinim të pasaktë lidhur me gjendjen cash në shtëpi, në deklaratat periodike vjetore në raport edhe me gjendjen cash në deklaratën vetting [...] Subjekti nuk ka deklaruar saktë gjendjen cash dhe ndryshimet e saj në vite (shtesa dhe pakësime) në deklaratat periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI. [...] Në përgjigje të rezultateve, subjekti është munduar të paraqesë fakte dhe prova në kundërshtim me formularët e pasurisë dhe dokumentacionin e dorëzuar pranë ILDKPKI-së ndër vite. Konkretisht, subjekti ka deklaruar se në vitin 2003, bashkëshorti i saj nuk ka deklaruar gjendje cash në shtëpi dhe për këtë ka paraqitur një kopje të deklaratës së pasurisë, të dorëzuar në datën 18.03.2004. Kjo kopje e deklaratës e paraqitur nga subjekti (te formulari A5, “Likuiditete”) nuk përmban shënime lidhur me gjendjen cash në shtëpi, e cila ndryshon me deklaratën e paraqitur nga ILDKPKI-ja pranë Komisionit.*

Sipas deklaratës së paraqitur nga ILDKPKI-ja (deklarata e datës 18.03.2004) rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, te formulari A5, “Likuiditete”, ka deklaruar gjendje cash 0.8 milion lekë me burim – kursime nga të ardhurat. Kopje të kësaj deklarate, Komisioni ia ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit, si pjesë e rezultateve të hetimit... Në DPV-në e vitit 2004 (bashkëshorti) ka deklaruar: “Pakësim cash në shumën 500.000 lekë [...] Nga dokumentacioni që disponoj, kopje e DPV-së 2004, e bashkëshortit, nuk ka asnjë përshkrim lidhur me pakësimin e gjendjes cash në shtëpi, ndaj është e pamundur të jap shpjegime për një situatë të tillë [...] Kjo kopje e deklaratës, e paraqitur nga subjekti (te rubrika “Informacion Konfidencial”), nuk përmban shënime lidhur me ndryshimin e gjendjes cash në shtëpi, e cila ndryshon me deklaratën e paraqitur nga

ILDKPKI-ja, pranë Komisionit. Sipas deklaratës së paraqitur nga ILDKPKI-ja (deklarata e datës 24.03.2005) rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, te formulari “Informacion Konfidencial”, ka deklaruar: “Pakësuar cash në shumën 500.000 lekë. Kopje të kësaj deklarate periodike, Komisioni ia ka vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit, si pjesë e rezultateve të hetimit. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti është munduar të shfaqë në mënyrë të pasaktë faktet dhe rrethanat lidhur me deklaratimet e bëra sa i përket gjendjes cash ndër vite... Gjithashtu, subjekti ka pretenduar, në mënyrë jo të drejtë, se deklaratat periodike vjetore të bashkëshortit të saj nuk i janë vënë në dispozicion nga Komisioni.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se veprimet e subjektit janë kryer në kundërshtim me ligjin, duke shtrembëruar faktet dhe provat shkresore, si dhe veprimet saj, për të shfaqur një situatë tjetër joreale, cenojnë figurën si magjistrate. Ky vlerësim i Komisionit do të merret në konsideratë në qëndrimin përfundimtar, bazuar edhe në çështjet e tjera, të evidentuara për subjektin e rivlerësimit. [...]

6. Shumica e trupit gjykues ka konkluduar se: [...] kur pasaktësitë në deklaratime në vitet e para të plotësimit të deklaratave të pasurisë për gjendjen e cash-it, nga ana e subjektit dhe personit të lidhur, nuk shoqërohen me pamundësi financiare për krijimin e tij, ato nuk mund të konsiderohen se janë paraqitur për të shtrembëruar faktet dhe provat shkresore e të trajtohen si veprime që cenojnë figurën e magjistratit. Trupi gjykues vlerëson se kjo rrethanë nuk ka elementet e mjaftueshme për ta konsideruar si shkak shkarkimi, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. [...]

7. Unë, gjyqtare në pakicë, vlerësoj se ky konkluzion i shumicës nuk mbështetet në një vlerësim të plotë të fakteve dhe provave të administruara, por e shoh si përpjekje për të minimizuar situatën reale të konstatuar, si dhe veprimet e kryera nga subjekti. Konkluzioni i Komisionit është i qartë dhe evidenton dukshëm veprimet e ndërmarra nga subjekti për të kaluar këtë gjetje mbi deklaratimet cash, ndërkohë që shumica e shmang vlerësimin e këtyre veprime, pa i dhënë peshën duhur, si dhe duke i konsideruar ato të pamjaftueshme si shkak për shkarkim. Në vlerësimin tim, veprimet e subjektit janë sjellje që cenojnë besueshmërinë e saj dhe nuk përmbushin standardet e kërkuara, për të qenë funksionar i sistemit të drejtësisë.

7.1. Nga aktet në dosje të Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, për të justifikuar pasaktësitë e konstatuara në deklaratim të gjendjes cash nga subjekti, në deklaratat periodike vjetore të viteve 2003 – 2005, në raport me deklaratimet e bashkëshortit në deklaratimet e këtyre viteve, ka paraqitur si dokumentacion, dy deklarata periodike vjetore të bashkëshortit të saj të këtyre viteve, të ndryshme nga përmbajtja e tyre nga ato të administruara në dosje të ILDKPKI-së.

7.2. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, si gjyqtare në pakicë, nuk i vlerësoj të besueshme dhe shteruese shpjegimet e dhëna nga subjekti, gjatë hetimit administrativ, mbi dinamikën e hartimit të deklaratave periodike vjetore nga bashkëshorti. Konkluzioni i shumicës së trupit gjykues, nuk merr në konsideratë dhe nuk analizon në mënyrë të mjaftueshme rrethanën thelbësore, se deklaratat e paraqitura nga subjekti, të cilat pretendon se i ka patur në banesë si “draft”, nuk provohen si të tilla, por përkundrazi rezultojnë se ato janë dokumente me të njëjtat të dhëna për sa i përket numrit të faqeve dhe datave të dorëzimit dhe administrimit në ILDKPKI, çka vë në dyshim seriozisht besueshmërinë e tyre dhe shpjegimet e subjektit.

7.3. Për rrjedhojë të sa më sipër, rrethanat e konstatuara rëndojnë pozitën e subjektit të rivlerësimit, e cila ka paraqitur dy versione të ndryshme të të njëjtave deklarata periodike, në kundërshtim me dokumentacionin zyrtar të administruar. Kjo situatë sjelljeje thellohet më tej, në kushtet kur subjekti ka pretenduar se Komisioni nuk i ka vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës, ndërkohë që ato

kanë qenë pjesë e dosjes së hetimit administrativ dhe i janë bërë të njohura subjektit me rezultatet e hetimit.

7.4. Në këtë kuptim, paraqitja e dokumenteve me përmbajtje të ndryshme, nuk mund të anashkalohet nga shumica, por duhet të vlerësohet në mënyrë të plotë në kuadër të besueshmërisë së subjektit. Për mua, si gjyqtare në pakicë, konkluzioni i Komisionit se: *Subjekti është munduar të shfaqë në mënyrë të pasaktë faktet dhe rrethanat lidhur me deklaratimet e bëra sa i përket gjendjes cash ndër vite, si dhe veprimet e saj janë kryer në kundërshtim me ligjin, duke shtrembëruar faktet dhe provat shkresore, për të shfaqur një situatë tjetër joreale, e cenojnë figurën e saj si magjistrate, është i drejtë dhe duhet pranuar.*

A/3. Lidhur me shpenzimet e djalit të subjektit të rivlerësimit në Kanada

8. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se rrethanat e konstatuara në lidhje me shpenzimet e djalit të subjektit, në Kanada, nuk mund të analizohen vetëm në drejtim të përcaktimit të mundësisë financiare të subjektit dhe personit të lidhur, por në radhë të parë, në drejtim të përmbushjes së detyrimit të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës, për një deklaram të saktë dhe të mjaftueshëm, duke i mundësuar institucioneve të rivlerësimit kontrollin dhe analizimin e plotë të tyre. Fakti që subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar ekzistencën e disa shpenzimeve (qira dhe shkollim), nuk është i mjaftueshëm për të konsideruar se është mundësuar një kontroll i plotë nga organet e rivlerësimit, për sa kohë deklarata e pasurisë *vetting*, nuk është shoqëruar me dokumentacion të plotë dhe shterues, që të lejojë verifikimin e saktë të deklarimeve.

8.1. Në vlerësimin tim, mosdeklarimi nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting* të llogarisë bankare të djalit, në Kanada, dhe mosshoqërimi me dokumentacion provues të kësaj të dhënë, e bën deklaramin e subjektit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, në kohën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ishte brenda afatit kohor për të mundësuar nga banka sigurimin e plotë të këtij dokumentacioni, ndryshe nga sa ka pretenduar.

8.2. Në vijim, paraqitjen e qëllimshme nga subjekti të të dhënave bankare të pjesëshme për periudha të caktuara, e vlerësoj si pengesë për të ushtruar kontrollin financiar nga Komisioni, duke krijuar një situatë të paqartë mbi nivelin real të shpenzimeve dhe burimeve të tyre. Kjo rrethanë nuk mund të shmangej nga shumica, pasi e konsideroj si sjellje jobashkëpunuese gjatë këtij procesi, sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

8.3. Ndryshe nga sa ka arsyetuar shumica e trupit gjykues, çmoj se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, nuk kishin mundësi të përballonin shpenzimet e jetesës, krijimin kursimeve dhe pagesën e shpenzimeve për shkollim dhe jetesë të djalit, në Kanada, në vitet 2009, 2012, 2013 dhe 2016, për një diferencë negative në shumën (-) 1.754.250 lekë.

8.4. Për mua gjyqtare në pakicë, ashtu sikurse parashtrova më sipër, e vlerësoj të drejtë konkluzionin e Komisionit se: *[...] krahas mungesës së të ardhurave të ligjshme për përballimin e shpenzimeve për shkollimin e djalit të tyre, në Kanada, është përpjekur të fshehtë dokumentacion lidhur me veprimet bankare të kryera nga djali i saj, pranë bankës në Kanada, "R.B.C", duke e vendosur në këtë mënyrë Komisionin në pamundësi për të hetuar lidhur me këtë likuiditet. Komisioni nuk e konsideron të vërtetë faktin se subjekti është në pamundësi për të vënë në dispozicion të dhënat bankare për veprimet e kryera nga djali i saj, si person i lidhur, para viteve 2016, pasi ajo nuk provoi përmbushjen e kërkesave ligjore të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Në përgjigje të pyetësorit standard të dërguar nga Komisioni, subjekti ka paraqitur si provë për të vërtetuar pagesat e qirasë së djalit,*

pjesë të statement-it bankar të "R.B.C", që datojnë nga data 17.11.2014 deri në gusht të vitit 2016. Pra, subjekti ka paraqitur vetëm disa pjesë të statement-it bankar (faqe të ndryshme të shkëputura), që lidhen vetëm me kryerjen e pagesës së qirasë, por nuk ka vënë në dispozicion statement-in e plotë lidhur me veprimet e kryera në këtë llogari bankare, nga ana e djalit të saj. Komisioni krijon bindjen se subjekti ka pasur në dispozicion kopje të plotë të statement-it lidhur me llogarinë bankare të djalit të saj, pranë "R.B.C", por nuk ia ka vënë të plotë në dispozicion Komisionit, që do të mundësonte kryerjen e një analize të plotë financiare lidhur me shpenzimet e kryera në këtë llogari bankare. [...]

9. Në përfundim të kontrollit të kriterit të vlerësimit të pasurisë, në konsideratë të sa arsyetuar më lart, vlerësoj se në analizë financiare duhet të përfshihen vetëm të ardhurat për të cilat kanë rezultuar të paguara detyrimet tatimore, konform legjislacionit në fuqi. Në këto kushte, nga analiza financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të përballonte shpenzimet dhe të krijonte kursime me burime të ligjshme, për periudhën e rivlerësimit, për vitet 2005 – 2016, për një diferencë negative në shumën (-) 9.546.708 lekë.
10. Përsëri, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vendimin e shumicës, mungon analiza lidhur me pasurinë "apartament banimi me sipërfaqe 151 m²", ndodhur në {***}, Tiranë, ku Komisioni ka konkluduar se: *Regjistrimi i pasurisë "apartament me sip. 151 m²", në vitin 2000, është bërë para kryerjes së pagesës në vlerën 5.000.000 lekë, me burim kredinë tek ish-Banka e Kursimeve, pavarësisht paraqitjes nga subjekti të kontratave të ngjashme, e ka vlerësuar se ky çmim është më i lirë se vlera e tregut, aty linden dyshime për favorizim të çmimit të blerjes së kësaj pasurie dhe duhen hetuar dhe vlerësuar edhe elemente të tjera. Çështjet e gjykuara nga subjekti me palë shoqërinë "{***}" ShPK u konstatuan se janë kryer disa vite më vonë se momenti i përfundimit të transaksionit të blerjes së apartamentit. Komisioni, në analizë të fakteve të dala në raport me legjislacionin që rregullon situatën e konfliktit të interesit, e lidhur ngushtë me veprimtarinë gjyqësore/procedurale të saj si gjyqtare, rregulluar nga Kodi i Procedurës Civile, nenet 72 dhe 73 të tij, konstaton se nuk provohet gjendja e konfliktit faktik të interesit, por, pavarësisht këtij konstatimi, Komisioni këtë situatë e çmon në kontekstin e cenimit të integritetit, si pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale, e për rrjedhojë, e ka mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Për mua, si gjyqtare në pakicë, ky konkluzion i Komisionit është i drejtë dhe duhet të ishte trajtuar në vlerësimin tërësor të çështjes, gjë të cilën, shumica e ka shmangur pa e trajtuar në vendim.*

B. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

B/1 Mbi konstatimin e tejkalimit të afateve të gjykimit të çështjeve

11. Në vlerësimin tim, konkluzioni i shumicës së trupit gjykues se: *[...] gjetjet në drejtim të tejkalimit të afatit të gjykimit prej 6 muajsh, i cili përbën një afat orientues, nuk mund të marrin peshë e të sjellin efekte në drejtim të vlerësimit të efektivitetit dhe produktivitetit të një gjyqtari, nëse ato nuk merren në shqyrtim dhe vlerësohen në kompleks, në harmoni dhe në raport edhe me indikatorët e tjerë të përcaktuar sipas këtij sistemi vlerësimi [...], nuk mbështetet në aktet e administruara dhe në legjislacionin e zbatueshëm në vlerësimin e këtij kriteri.*

11.1. Nga aktet e administruara në Komision, konkretisht referuar raportit profesional të hartuar nga KLGj-ja, rezultoi e provuar se në *tetë (8) çështje të vëzhguara*, gjykimi nga subjekti i rivlerësimit për katër (4) prej tyre, ka tejkeluar standardin orientues të përcaktuar nga pika 5, shkronja "e" e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me aspektin kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm, të përcaktuar prej 6 muajsh.

11.2. Nga verifikimi i dosjeve gjyqësore rezulton se tejkalimet i afateve nuk janë rastësore, por të pranishme në disa çështje të analizuara, përfshirë vendimet e paraqitura nga vetë subjekti, dosjet e shortuara dhe rastet e trajtuara në kuadër të denoncimeve. Ndryshe nga shumica, çmoj se këto gjetje nuk mund të anashkalohen, pasi ato përbëjnë tregues konkretë, që lidhen me efektivitetin dhe produktivitetin e ushtrimit të funksionit të gjyqtares.

11.3. Për më tepër, aftësia e subjektit për gjykimin brenda afateve ligjore të çështjeve është bërë edhe objekt ankesash gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit. Për sa i përket denoncimeve, në kundërshtim me vlerësimin e shumicës, çmoj se pretendimet e ngritura nga denoncuesit mbeten të provuara dhe përforcojnë gjetjet mbi problematikat për subjektin e rivlerësimit në zvarritjen e gjykimit të çështjeve.

11.4. Në vlerësimin tim, gjetjet dhe mangësitë e konstatuara, në raportin e hartuar nga KLGj-ja, reflektojnë një model pune të subjektit të rivlerësimit, i cili duhet vlerësuar sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të çështjes.

B/2 Lidhur me konstatimin mbi mosrespektimin e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 06.12.2013

12. Nuk jam dakord me qëndrimin e shumicës sa i përket vlerësimit mbi mosrespektimin nga ana e subjektit të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 06.12.2013, të konstatuar në rastin e dosjes të listuar me nr. {***}, në raportin profesional të hartuar nga KLGj-ja, si dhe në rastin e denoncimit të shtetasit V. B.

12.1. Nga analizimi i këtyre dy rasteve rezulton se vendimi unifikues nuk është zbatuar dhe nuk është marrë në konsideratë nga subjekti. Ndryshe nga shumica, çmoj se nuk kemi të bëjmë me një rast të veçuar apo vendim të dhënë në kushtet e konfuzionit të shkaktuar nga vetë Gjykata Administrative, por me një devijim nga standardi i detyrueshëm, i vendosur nga vendimi unifikues, i cili synon garantimin e njëtrajtshmërisë së praktikës gjyqësore.

12.2. Pretendimet e subjektit se është normale që gjatë gjykimit, gjykata më e lartë të bëjë vlerësim të rrethanave të çështjes në një këndvështrim të caktuar, nuk qëndrojnë, pasi në rastin konkret, vlerësoj se nuk kemi të bëjmë me çështje këndvështrimesh, por me aftësinë e gjyqtarit për të interpretuar ligjin, identifikuar konfliktin e normave dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën, si nënindikatorë të përcaktuar nga neni 72 i ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, vlerësoj se mbetet e provuar marrja e vendimeve nga subjekti, në kushtet e moskompetencës lëndore, për çështje të regjistruara në gjykatë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012, si dhe pas daljes së vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

*B/3 Lidhur me konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK*

13. Ashtu sikurse dhe Komisioni, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se, pavarësisht se në momentin e shqyrtimit të çështjeve me palë shoqërinë “{***}” ShPK, ose me drejtuesit saj, nuk provohet gjendja e konfliktit të interesit, rezultojnë disa rrethana, të cilat janë të mjaftueshme për t’u vlerësuar në drejtim të paanësisë dhe të kujdesit që subjekti i rivlerësimit duhej të tregonte ndaj konfliktit të interesit, si indikatorë matës nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

13.1. Rrethanat e tilla si: (i) pasuria “apartament banimi”, e krijuar nga subjekti i rivlerësimit, vjen si rezultat i marrëdhënies kontraktore me shoqërinë “{***}” ShPK dhe administratorin e saj; (ii) marrëdhënia e dukshme e mirëbesimit mes palëve, reflektuar nëpërmjet kalimit pa kushte të pronësisë së apartamentit me sip. 151 m², në Zyrat e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, ende pa u lëvruar

kredia dhe pa asnjë parapagim, si dhe faktit se (iii) çmimi i përcaktuar prej 5.000.000 lekësh, pikërisht sa vlera e kredisë së lëvruar, rezulton ndjeshëm më i ulët se vlera e tregut të lirë në ato vite, prej 8.502.206 lekësh²⁸, tregojnë për një marrëdhënie të tillë mes palëve, e cila tejkalon një marrëdhënie të thjeshtë kontraktore shitblerje pasurie. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit duhet të hiqte dorë nga gjykimi i këtyre çështjeve me palë ndërgjyqëse shitësin e apartamentit.

13.2. Kjo situatë, në vlerësimin tim, duhej të ishte mbajtur në konsideratë nga shumica, në vlerësimin tërësor të procedurave, së bashku me gjetjet e tjera në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

*B/4 Lidhur me çështjet e shqyrtuara nga subjekti me shoqërinë “{***}” ShPK dhe shoqërinë “{***}” ShA*

14. Nuk jam dakord me konkluzionin e shumicës, lidhur me mungesën e konfliktit të interesit nga subjekti i rivlerësimit në çështjet gjyqësore, që lidhen me shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK. Në vlerësimin tim, nga analiza e akteve dhe rrethanave konkrete, rezulton se ekzistojnë elemente që krijojnë një perceptim të arsyeshëm për konflikt interesit. Konflikti i interesit, sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

14.1. Në vlerësimin tim, natyra e marrëdhënies që personi i lidhur me subjektin kishte me shoqërinë “{***}” ShPK, që nga viti 2005 deri në vitin 2010, për sa më sipër trajtuar, si dhe komunikimet me këtë shoqëri, deri në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, nga syri i një vëzhguesi të jashtëm, duket se e vënë në diskutim paanësinë e subjektit në gjykimin e çështjeve, në të cilat kjo shoqëri ishte pale. Mbi të gjitha, marrëdhënia me këtë shoqëri ka siguruar të ardhura të konsiderueshme për personin e lidhur dhe subjektin e rivlerësimit.

14.2. Ndryshe nga shumica e trupit gjykues, çmoj se, edhe në rastin e çështjeve që lidhen me “{***}” ShPK, nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.06.2023, ka përcjellë informacion mbi datat e shortimit të këtyre çështjeve te subjekti i rivlerësimit. Kërkesat e subjektit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes me palë “{***}” ShPK janë bërë disa muaj pas shortimit të çështjes, në periudha që përkojnë dhe me ecurinë e procesit të rivlerësimit.

14.3. Në përfundim, lidhur me konfliktin e interesit, vlerësoj se, ndryshe nga sa ka arsyetuar shumica e trupit gjykues, sjelljet e subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të përsëritur, në drejtim të shmangies së konfliktit të interesit, nuk duhen vlerësuar të fragmatizuara, por së bashku me gjetjet e tjera, në drejtim të cenimit të indikatorit të parashikuar në nenin 75, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale vlerësohen nga paanësia e magjistratit dhe kujdesi i tij ndaj konfliktit të interesit.

B/5 Lidhur me përdorimin e mbiemrave të ndryshëm

15. Unë, gjyqtare në pakicë, e vlerësoj të drejtë konkluzionin e Komisionit, duke i konsideruar jobindëse shpjegimet e subjektit për përdorimin e mbiemrit ndryshe nga ai zyrtar, i regjistruar në gjendjen civile,

²⁸ Sipas këtij udhëzimi Komisionit i ka rezultuar se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës është në vlerën 56,306 lekë për m². Sipërfaqja e ndërtimit të apartamentit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është në total 151 m².

kryesisht në vendimet gjyqësore të dhëna prej saj. *Magjistrati duhet të tregojë përgjegjshmëri dhe shembull qytetarie si zbatues i ligjit dhe jo të kryejë veprime vetë me ndërjegje në shkelje të ligjit, pasi kjo cenon besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Situata e krijuar nga përdorimi i mbiemrit në mënyrë të vazhdueshme me dijeni dhe ndërjegje, e ndryshme nga ai zyrtar, është e paprecedentë në rastet e trajtuara në procesin e rivlerësimit kalimtar. Komisioni, me të drejtë, ka konstatuar se subjekti, edhe pse jep shpjegime lidhur me këtë situatë absurde të përdorimit në dokumente zyrtare të mbiemrit Muça (i ndryshëm nga mbiemri zyrtar Muço), përsëri vazhdon me koshiencë përdorim e këtij mbiemri edhe në përgjigjet mbi rezultatet e hetimit, duke i vlerësuar si sjellje që cenojnë etikën, rolin dhe figurën e një magjistrati.*

16. Shumica e ka konsideruar pa peshë përdorimin e mbiemrave të ndryshëm nga subjekti i rivlerësimit dhe të pamjaftueshëm për t'u reflektuar në vlerësimin tërësor, në drejtim të marrjes së masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit. Në vlerësimin tim, përdorimi i një mbiemri të ndryshëm nga ai zyrtar, në vendimmarrje, nuk mund të trajtohet thjesht si një gabim material pa pasoja. Përkundrazi, kjo sjellje përbën një parregullsi të përsëritur, e cila prek drejtpërdrejt elemente thelbësore të ushtrimit të funksionit gjyqësor, si siguria juridike, saktësia formale e akteve dhe identifikimi i qartë i subjektit që ushtron funksionin publik.

16.1. Ndryshe nga shumica e trupit gjykues, çmoj se shpjegimet e dhëna nga subjekti, megjithëse lidhen me problematika të mundshme të regjistrave të gjendjes civile ndër vite, nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar përdorimin sistematik të një mbiemri të ndryshëm në vendimet gjyqësore. Në këto kushte, kjo praktikë nuk mund të normalizohet, por duhet të vlerësohet si një element që cenon standardet e kërkuara për korrektësinë dhe seriozitetin e figurës së magjistratit. Për rrjedhojë, vlerësoj se kjo rrethanë duhet të ishte trajtuar nga shumica e trupit gjykues në lidhje me etikën dhe sjelljen e subjektit në ushtrimin e detyrës.

17. Në përfundim, mbështetur në analizën e mësipërme, problematikat e evidentuara në drejtim të:

17.1. (i) *Paraqitjes së “marrëveshjes së bashkëpunimit”, të vitit 2005, jo në formën e kërkuar nga ligji nga subjekti, përgjatë hetimit administrativ, konkretisht pas pyetësorit të 3-të, në Komision; (ii) Veprimeve të subjektit të rivlerësimit, sikurse ngritja e padisë në gjykatë, nga personi i lidhur i subjektit për t'i dhënë fuqi ligjore kësaj marrëveshje, si dhe më pas paraqitja e vendimit gjyqësor në Kolegj, (vendim i cili i përket vitit 2024), është përpjekje e subjektit për të provuar se detyrimet tatimore sipas kësaj marrëveshje i përkisnin shoqërisë, për shumën e përfutur në vlerën 73.000 euro; (iii) shmangies së vullnetshme, sipas analizës më sipër, nga pagesa e detyrimeve tatimore mbi të këtë të ardhur, si dhe (iv) i moskalimit të testit të ligjshmërisë të këtyre të ardhurave sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, çmoj se janë veprime të subjektit për t'i vlerësuar në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

17.2. *Shpjegimeve jobindëse të subjektit mbi gjendjen cash si dhe përpjekjet e subjektit, pas kalimit të barrës së provës në Komision, për të shtrembëruar faktet dhe provat shkresore, si dhe për të shfaqur një situatë tjetër joreale lidhur me deklarimet e viteve 2003 – 2005, të ndryshme nga përmbajtja e deklaratave periodike vjetore, pjesë e fashikullit të ILDKPKI-së.*

17.3. *Paraqitjes në mënyrë të pjesshme të llogarive bankare të djalit të subjektit në Kanada, mungesës të bashkëpunimit të subjektit të rivlerësimit, sa i përket vënies në dispozicion në mënyrë jo të plotë të tyre, duke krijuar vështirësi në verifikimin dhe kontrollin e plotë të analizës financiare nga Komisioni dhe Kolegji.*

17.4. Gjykimit të çështjeve në tejkalim të afateve ligjore, e konstatuar në mënyrë të përsëritur në punën e subjektit të rivlerësimit, madje edhe në dosjet e përzgjedhura për vlerësim nga vetë subjekti.

17.5. Gjykimit të çështjeve në kundërshtim me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 06.12.2013.

17.6. Mungesës së kujdesit ndaj situatave të konfliktit të interesit, e evidentuar në mënyrë të përsëritur në disa raste të gjykimit të çështjeve, në të cilat palë kanë qenë shoqëritë ku personi i lidhur me subjektin ka përfitur të ardhura.

17.7. Evidentimit të problematikave në denoncimet e administruara.

17.8. Papërgjegjshmërisë së subjektit të rivlerësimit ndaj përdorimit të mbiemrave të ndryshëm nga mbiemri zyrtar, në vendimet gjyqësore dhe në aktet shkresore, duke vijuar edhe përgjatë procesit të rivlerësimit.

Ndryshe nga sa ka vlerësuar shumica e trupit gjykues, çmoj se janë rrethana të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Blerina Muço, krahas deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka cenuar besimin e publikut, sipas nenit 61, pika 5, të po këtij ligji.

18. Në vlerësimin tim, shumica e trupit gjykues, me këtë vendimmarrje, është shmangur nga standardet e ndjekura në rastet e ndryshimit të vendimit të Komisionit dhe të konfirmimit në detyrë të subjekteve të rivlerësimit. Për këtë arsye, kam votuar *kundër*, duke qenë e bindur se vendimi i Komisionit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është i drejtë, i mbështetur në fakte ligjore dhe në ligj dhe, si i tillë, duhej të lihej në fuqi.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi